

**FJALA SHQIPE
NË VEND TË
FJALËS SË HUAJ**

Mitrovicë,
më 2000

Fjalët i voli nga revista “GJUHA JONË”:

Shaban KELMENDI

Radhitja dhe përgatitja kompjuterike:

Muhamed DOLAKU

FJALA SHQIPE NË VEND TË FJALËS SË HUAJ

Puna për pastrimin e gjuhës sonë të njësuar letrare nga fjalët dhe ndërtimet e huaja të panevojshme, që mbështetet në një traditë të pasur duke nisur që nga Rilindja, ka ardhur duke u forcuar gjithnjë e më tepër pas Çlirimit të vendit. Në shtypin tonë, jo vetëm në organet gjuhësore e periodike, por edhe në shtypin e përditshëm, janë botuar dhe vazhdojnë të botohen artikuj e materiale të ndryshme për këto çështje. Këto kanë qenë dhe janë një ndihmë e madhe për punën me gjuhën. Në fazën e sotme të zhvillimit të gjuhës letrare, kur kjo gjuhë është bërë pronë e masave të gjera punonjëse dhe kur edhe terminologjia teknike e shkencore ka marrë një përdorim mjaft të gjerë, del nevoja që puna për pastrimin e gjuhës letrare kombëtare nga huazimet e panevojshme të marrë nga karakter më të organizuar dhe përmasa më të gjera. Për këtë qëllim Komisioni i përhershëm për pastrimin dhe pasurimin e mëtejshëm të gjuhës letrare vendosi të ngrihet një grup pune i veçantë, i përbërë nga studiuesit: Androkli Kostallari (kryetar). Mahir Domi (zv/kryetar), Engjëll Angoni (sekretar), Shaban Demiraj, Anastas Dodi, Emil Lafa, Jani Thomaj, Ali Dhrimo, Xhevat Lloshi, Ferdinand Leka, Reshat Konçi, Stefan Bulo, Kolë Ashta (anëtarë). Ky grup ka filluar nga veprimtaria e tij dhe ka shqyrtuar e miratuar një varg propozimesh për zëvendësimin e fjalëve të huaja me fjalë të shqipes. Puna e grupit do të pasqyrohet rregullisht në faqet e revistës sonë.

Duke filluar nga ky numër revista "Gjuha jonë" do të botojë përmbledhje fjalësh të huaja, të cilat mund dhe duhet të zëvendësohen me fjalë shqipe. Këtu përfshihen si fjalë të leksikut të përgjithshëm ashtu edhe fjalë që përdoren si terma në fushat e ndryshme të shkencës, të teknikës, të prodhimit dhe në fusha të tjera të veprimtarisë shoqërore. Krahas fjalëve do të botohen edhe materiale për zëvendësimin e ndërtimeve të huaja që dëmtojnë veçantinë kombëtare të gjuhës sonë e që nuk pajtohen me strukturën e saj gramatikore e leksikore.

Puna për pastrimin e pasurimin e mëtejshëm të gjuhës letrare

mbështetet në kriteret shkencore që përcaktohen në platformën e veçantë, e cila u miratua nga Komisioni i përhershëm për këtë qëllim (shih nr. 1 të revistës “Gjuha jonë”. Duke u nisur nga kjo platformë, grupi i punës do të mbështetet në veprimtarinë e tij sidomos në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” (1980) e në Kartotekën e Leksikut të Shqipes si edhe në studimet nga fushat e ndryshme të gjuhësisë e në kartotekat e veçanta pranë Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.

Redaksia e revistës “Gjuha jonë” fton të gjithë lexuesit që jo vetëm t’i shtien në përdorim fjalët dhe shprehjet shqipe që po botohen, por të bëjnë edhe propozime të reja që mund ta pasurojnë e plotësojnë këtë lëndë.

REDAKSIA

abandonoj kal. Nuk ka ndonjë arsye të përdoren në gjuhën tonë fjalë të tilla si **abandonoj**, **abandonohem**, **i abandonuar** që kanë hyrë si huazime nga vitet 30, kur shqipja ka fjalë të bukura, të kuptueshme për të gjithë që kanë të njëjtin kuptim si: **lë**. **lë pas dore**, **braktis**, **i braktisur**, p.sh.: *Nuk e kanë lënë shpresat. S'e lë pas dore punën. Braktisën anijen. Shtëpi e braktisur.*

abnegacion, **~i** m. Kjo fjalë e huaj zëvendësohet plotësisht me fjalën shqipe **vetëmohim**, e cila për nga kuptimi nuk ka ndonjë ndryshim me huazimin, p.sh: *Vetëmohim i lartë. Punë plot vetëmohim. Luftoi me vetëmohim.*

abonim, **~i** m., **abonoi** kal., **abonohem** vetv., **abonuar** (i, e) mb. Këto zëvendësohen plotësisht me fjalët shqipe **pajtim**, **pajtoj**, **pajtohem**, **pajtimtar**, që kanë nisur të përdoren me këtë kuptim që në fillim të këtij shekulli. Ato kanë marrë një përhapje të madhe në gjuhën e sotme, megjithatë ende dëgjohen edhe fjalët e huaja, të cilat janë krejt të panevojshme. Mund të themi fare mirë: *Kam pajtuar vajzën në revistën "Pionieri". U pajtova për një vit në gazetën "Bashkimi". Pajtimet në shtyp bëhen dy herë në vit. "Zëri i rinisë" ka shumë pajtimtarë etj.*

abrogim, m., **abrogoj** kal., **abrogohet** pës., **abroguar** (i,e) mb. Në vend të këtyre fjalëve të huaja tashmë kanë hyrë në përdorim fjalët shqipe të këshilluara nga A. Xhuvani: **shfuqizim**, **shfuqizoj**. **shfuqizohet**, **i shfuqizuar**.

absorboj kal., **absorbim**, **~i** m., **absorbues**, **~e** mb. Folja **absorboj**, me temë të huazuar nga gjuhët neolatine, përdoret zakonisht në letërsinë tekniko-shkencore me kuptimin "e tërheq diçka dhe e mban brenda vetes, e thith tërësisht". Në këtë kuptim, kryesisht terminologjik, ashtu siç këshillon edhe "Fjalori i terminologjisë tekniko-shkencore të kimisë...", kjo fjalë zëvendësohet me fjalën shqipe **përthith**, që e ka edhe "Fjalori i gjuhës së sotme shqipe" (1980) (më tej — FGJSSH), p.sh.: *Qymyri përthith ngjyrat e gazet ose avujt e lëndëve helmuese. Përthith një sasi nxehtësie. Përthith valët e zërit.* Edhe fjalët **absorbim**, **~i**, **absorbues**, **~e**, që janë formuar nga folja **absorboj**, zëvendësohen me fjalët shqipe **përthithj/e**, **~a** dhe **përthithës**, **~e**, p.sh. *Përthithja e lëngjeve* (në vend të: *Absorbimi i lëngjeve*). *Përthithja e nxehtësisë* (në vend të: *Absorbimi i nxehtësisë*). *Lëndë përthithëse* (në vend të: *Lëndë absorbuese*). Në kuptimin e figurshëm, në vend të fjalës së huaj përdoren fjalët shqipe **thith**, **përvetëson**, **bën të vetën**, p.sh. *Poezia e re shqiptare ka thithur (ka bërë të vetën) në mënyrë krijuese edhe vlerat e poezisë sonë folklorike.*

abuzim, **~i** m., **abuzoj** kal., **abuzohet** pës., Në gjuhën tonë për këto fjalë e ndonjë tjetër të kësaj familjeje, si **abuzues**, janë krijuar e janë përdorur fjalët **shpërdorim**, **shpërdoroi**, **shpërdorohet**, **shpërdorues**. Këto fjalë

shqipe tashmë kanë hyrë gjerësisht në të gjitha stilet duke nxjerrë jashtë, si krejt të panevojshme, huazimet, p.sh.: **Shpërdorimi** i energjisë elektrike. **Shpërdor**oj besimin. Shpesh në shqipen këto huazime mund të zëvendësohen edhe me fjalët **teprim**, **teproj**, **teprohet**, p.sh.: *Po, për sa u përket shkrimeve të tjera, ato ishin një kampanë e tillë alarmi kundër teprimeve (abuzimeve), ryshfeteve... Të mos teprohet (abuzohet) me mbledhje! E teproj (abuzoj) në pije* etj.

açik ndajf. Në vend të kësaj fjale që ka hyrë në gjuhën tonë nga turqishtja, mund të përdoren fare bukur fjalët shqipe **hapur**, **sheshit**, **qartë**, p.sh: *Duket qartë (sheshit). Ia tha hapur. Doli sheshit* etj. (Fjala **açik** ka kuptimin edhe **çelur** (i, e); **çiltër** (i, e); **ndaras**; **veçmas** (MD).

adapt, ~e mb. Ky mbiemër me prejardhje të huaj përdoret kryesisht për të cilësuar një njeri që ka aftësitë e vetitë e nevojshme për t'u marrë me diçka, për të bërë një punë etj. Kështu p.sh. thuhet: *Njeri adapt për këtë detyrë. Njerëz (persona) adaptë* etj. Këtë kuptim e jep fare mirë fjala shqipe **përshtatshëm**, prandaj duhet të themi *Njeri i përshtatshëm. Njerëz më të përshtatshëm. Është i përshtatshëm për atë detyrë* etj.

adaptoj kal., **adaptohem** vetv., **adaptim**, ~i m. Këto fjalë mund të zëvendësohen fare mirë në të gjitha kuptimet e përdorimet nga fjalët shqipe **përshtat**, **përshtatem**, **përshtatje**. *E përshtatën klubin për sallë shfaqjesh. E përshtatën organizmin për një klimë të ftohtë. Çajupi ka përshtatur fabulat e La Fontenit. Nuk u përshtatet rrethanave të reja. Përshtatje e organizmit. Përshtatje e bërë me mjeshtëri.*

adash, ~i m. Fjalë me prejardhje nga turqishtja, me kuptimin “ai që ka të njëjtin emër me një tjetër”; nuk e ka “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe”. Për këtë në “Fjalor” jepen tri fjalë shqipe: **emnak**, **njëemnak** dhe **njëemërsh**. Nga këto më e përshtatshme është fjala **emnak**, p.sh. *Ne jemi emnakë, se të dy e kemi emrin Bashkim.*

adio *pasth*. Kjo fjalë e huazuar nga italishtja po përdoret gjithnjë e më pak dhe kryesisht në gjuhën e folur. Në vend të fjalës **adio**, që lidhet me botëkuptimin fetar, të huaj për shoqërinë tonë (formuar nga përngjitja e parafjalës **a** “te” me emrin **Dio** “Zoti”) gjuha shqipe ka përshtatjet e bukura **lamtumirë** dhe **mirupafshim**. Fjala **lamtumirë** përdoret si përshtatje kur largohemi për në një vend tjetër ose kur ndahemi nga një njeri i dashur a diçka për një kohë të gjatë a përgjithnjë, ndërsa fjala **mirupafshim** përdoret si shprehje kur ndahemi nga një njeri i dashur a diçka për një kohë jo të gjatë.

afërim *pasth*. Në vend të kësaj fjale turke, që ndeshet rrallë në ligjërimin bisedor, kryesisht te brezi i vjetër, por edhe në letërsinë artistike për të tipizuar ndonjë personazh, në gjuhën tonë është përdorur prej kohësh fjala **të**

lumtë si për t'i shprehur dikujt pëlqimin, miratimin e përgëzimin për diçka, ashtu edhe për të shprehur admirim e lëvdatë për dikë, p.sh.: *Mirë e ke shkruar, të lumtë!* Shprehja “*aferim të qoftë*” ka fituar një kuptim ironik, shpreh njëfarë qesëndie. Për këtë shkak ajo mund të përdoret si mjet stilistik qoftë në letërsinë artistike, qoftë në ligjërimin bisedor.

agrar, ~e mb. Kjo fjalë, e huazuar nga italishtja, prej kohësh ka nisur të zëvendësohet me fjalën **bujqësor, ~e**. Edhe FGJSSH kuptimin e parë të kësaj fjale nuk e shpjegon, por e çon te **bujqësor, ~e**. p.sh.: *Vend bujqësor. Krahinë bujqësore. Bankë bujqësore. Sistemimi bujqësor.* Termi **agrar** vazhdon të përdoret në kuptimin e dytë, si term ndërkombëtar, të cilën FGJSSH e shpjegon: “që ka të bëjë me pronësinë mbi tokën, me zotërimin dhe me përdorimin e saj”, p.sh.: *Reforma agrare. Çështja agrare. Revolucioni agrar. Marrëdhënie agrare. Ligj agrar.* Edhe fjala e përbërë **agraro-industrial** zëvendësohet me **bujqësor-industrial**, ashtu siç e këshillon edhe FGJSSH: *Vend bujqësor-industrial.*

akcent, ~i m. Kjo fjalë e huaj përdoret kryesisht si term gjuhësor e muzikor. Në vend të saj kemi fjalën shqipe **theks: theks dinamik, theksi i fjalës, theks melodik.** Fjala akcent mund të zëvendësohet plotësisht edhe në kuptimet e tjera, kur përdoret për të treguar mënyrën e shqiptimit të tingujve, të fjalëve ose të fjalive në të folur, mënyrën e të folurit që është karakteristike për një njësi a një grup shoqëror, ndryshimin e zërit, që shpreh ndjenja të caktuara të folësit, p.sh.: *Theks i këndshëm (i butë, i ëmbël, i ashpër). Foli me theks të veçantë (të huaj) etj.,* ose kur përdoret **me** kuptim të figurshëm, p.sh.: *Foli me theks të veçantë për diçka. Mori një theks të ri etj.*

akçi, ~u m. Është fjalë e vjetruar e ligjërimin bisedor. Për këtë huazim nga turqishtja kemi fjalën shqipe **gjellëbërës**, p.sh.: *Mori një gjellëbërës të mirë për dasmë.* Edhe fjalën **akçeshë**, që është formuar nga fjala e huazuar **akçi-** me prapashtesën shqipe **-eshë**, s’kemi nevojë ta përdorim, sepse shqip themi fare mirë **gjellëbërëse**, p.sh.: *Gjellëbërëse e mbaruar. Gjellëbërëse e vjetër.*

akoma ndajf. Kjo është fjalë e huazuar nga greqishtja. Zëvendësohet në shumicën e kuptimeve e të përdorimeve me fjalët shqipe **ende, edhe**. Me fjalën **ende** zëvendësohet rregullisht kur përdoret në kuptimin “*deri në kohën kur flasim ose deri në çastin, për të cilin flasim*” p.sh.: *Punon ende. Ende nuk është përgatitur. Është ende i vogël. Nuk ka ardhur ende.* Po ashtu edhe kur përdoret me ngjyrim mospërfillës, kryesisht në ligjërimin bisedor. p.sh.: *Ende s’ka vdekur! Ende s’e ka thyer qafën!* Me fjalën **edhe** zëvendësohet kur përdoret me shkallën krahasore të ndajfoljeve dhe të mbiemrave: **edhe më shumë, edhe më tepër, edhe më i madh, edhe më i mirë.** Në ndërtime të tilla, si: **të (merr) akoma!**; **ka akoma** etj. fjala **akoma** mund të zëvendësohet sipas rastit me fjalët **përsëri, prapë** ose me shprehjet **edhe më, edhe ca, më**

tepër, ndërsa në fjali pyetëse si: *Do akoma? Gjen akoma?* mund të zëvendësohet edhe me fjalën **më**.

aks, **~i** *m.* Në letërsinë tekniko-shkencore takohet ndonjëherë fjala e huaj **aks**. Për këtë fjalë gjuha shqipe ka fjalën më të përgjithshme **bosht**. Pra, duhet thënë gjithmonë: **boshti** *i qerres*, **boshti** *i rrotullimit*, **boshti** *qendror*, **bosht** *simetrie*, **boshti** *i Tokës*, *makina me dy boshte* etj. Me kuptim të figurshëm me të drejtë përdoret vetëm fjala **bosht** e jo **aks**. P.sh: **boshti** *ideologjik*, **boshti** *i dramës* etj.

aksham, **~i** *mb.* Fjalë me prejardhje nga turqishtja, me kuptimin **mbrëmje**, **muzg**, **të ngrysur**, prandaj mund të përdoren këto fjalë të shqipes, siç këshillon FJGSSH, p.sh.: *Të dielën në mbrëmje (në të ngrysur)*. *Erdhi në mbrëmje (në të ngrysur)*.

aktivitet, **~i** *m.* Edhe pse me burim të huaj, ka ende një përdorim relativisht të gjerë sidomos në letërsinë politiko-shoqërore. Në njëjës po përdoret me sukses fjala shqipe **veprimtari**, por në numrin shumës përdoret ende fjala e huaj **aktivitetet**. Kështu. thuhet: **veprimtari** *politike*, **veprimtari** *shoqërore*, **veprimtari** *artistike*. **veprimtari** *krijuese*, **veprimtari** *revolucionare* etj., por në shumës vijon të thuhet: **aktivitetet** *artistike*, **aktivitetet** *kulturore*, **aktivitetet** *politike* etj. Edhe në shumës nuk ka asnjë arsye që të përliqë fjalën e huaj, prandaj duhet të zërë vend fjala shqipe. Pra. mund të thuhet e të shkruhet fare bukur: **veprimtaritë** *kulturore*, **veprimtaritë** *artistike* etj. Lidhur me këtë shqipërim duhet përkrahur më tej edhe zëvendësimi i fjalës **aktivist** me **veprimtar**, siç ka filluar të përdoret **veprimtar** *politik (shoqëror)*, **veprimtarët** e *Rilindjes* etj.

aktual, **~e** *mb.*, **aktualisht** *ndajf.* Fjala e huaj **aktual** përdoret si mbiemër kryesisht për të cilësuar kështu një ngjarje, një çështje, një gjendje, një rrethanë, një detyrë etj. që është e kohës, e ditëve tona. ose që ka rëndësi të veçantë për kohën e sotme, për çastin e tanishëm. Kështu thuhet **gjendja aktuale**, **ngjarjet aktuale**, **çështje aktuale**, **detyra aktuale**, **pjesë aktuale**, **tema aktuale**, **ka rëndësi aktuale** etj. Në vend të fjalës së huaj **aktual** duhet të përdoren, sipas rastit, fjalë dhe togje nga brumi i shqipes: **i sotëm**, **i tanishëm**, **i ditës**, **i kohës**, **i kohës sonë**, **i çastit**. Nga fjala e huaj **aktual** me prapashtesën shqipe **-isht** është formuar ndajfolja **aktualisht**. e cila përdoret ndonjëherë në stilin publicistik e në administratë. Edhe ndajfolja **aktualisht** zëvendësohet sipas kontekstit me fjalë e togje të shqipes: **sot**, **tashti**, **tashti për tashti**, **në çastin e tanishëm**, **në ditët tona**, **në kohën tonë**, **në gjendjen e tanishme**, **në rrethanat e sotme**, **në kushtet e sotme** etj.

alet, **~i** *m.* Kjo fjalë me burim nga turqishtja është përdorur në gjuhën shqipe me kuptimin "mjete, vegël pune". Është tashmë një fjalë e vjetruar,

prandaj përdoret rrallë. Në vend të saj përdoren me të drejtë fjalët **vegël, mjet**. Pra thuhet *mjetet e punës* dhe jo *aletet e punës, veglat e këpucarit* dhe jo *aletet e këpucarit* etj. Edhe ato pak raste të rralla të përdorimit të fjalës alet, që takohen aty-këtu në gjuhën e folur, duhen mënjeluar.

alt *pasth*. Këtë fjalë, të huazuar nga italishtja, FGJSSH nuk e jep, sepse në vend të saj përdoret fjala shqipe **ndal**, si në terminologjinë ushtarake ashtu edhe në atë sportive, p.sh.: - *Ndal! Kush kalon? Thirri me zë të lartë: "Ndal!"*.

aman *pasth*. Fjala **aman** me burim nga turqishtja përdoret si pasthirmë kryesisht në gjuhën e folur për të shprehur një lutje ose për të kërkuar falje a mëshirë. Në gjuhën e shkruar dhe shumë herë edhe në gjuhën e folur në vend të fjalës **aman** po përdoret shprehja shqipe **të lutem**. Shprehja e bukur shqipe **të lutem** duhet të shtrihet në të gjitha llojet e ligjëritimit. Pra, duhet thënë: *Të lutem, mos me shqetëso!* dhe jo *Aman, mos më shqetëso!*. *Të lutem, më merr dhe mua!* dhe jo *Aman, më merr dhe mua!* etj.

ambient *kal.*, **ambientohem** *vetv*. Në vend të këtyre fjalëve në një varg rastesh mund të përdoren fjalët shqipe **mësoj, mësohem** ose togfjalëshat **mësoj (mësohem) me mjedisin**, p.sh.: *mësoj organizmin, mësohem me klimën e ftohtë, me vendin e ri (me punën e re), u mësuva shpejt, mezi u mësuva këtu* etj.

ambient, i m. Në vend të kësaj fjale të huaj vitet e fundit ka filluar të përdoret gjerësisht fjala shqipe **mjedis** jo vetëm në kuptimet themelore, por edhe në kuptimet figurative e speciale. Fjala **ambient** dhe fjala **mjedis** sot për sot, si të thuash, bashkëjetojnë në gjuhën letrare, por pa arritur ende që fjala shqipe ta mbulojë plotësisht fjalën e huaj. Këtë gjendje pasqyron edhe "Fjalori i gjuhës së sotme shqipe" (më tej — FGJSSH), ku fjala **ambient** është zberthyer në pesë kuptime, ndërsa fjala **mjedis** në dy kuptime. Sidoqoftë prirja është që fjala **mjedis** të zëvendësojë fjalën **ambient** në shumicën e kuptimeve e të përdorimeve. Ja një varg thëniesh që dëshmojnë se si fjala **mjedis** mund ta zëvendësojë fare mirë fjalën e huaj **ambient** në kuptimet kryesore: *mjedisi_gjeografik, mjedisi natyror, mjedisi rrethues, mjedisi material, mjedis ajror (ujor), mjedisi i jashtëm, mbrojtja e mjedisit, ruajtja e mjedisit nga ndotjet* etj.; *mjedis shoqëror, mjedis i kulturuar, mjedis shqiptar, mjedis punëtor (fshatar), mjedisi familjar* etj.; *mjedis i ngrohtë, mjedis luftarak, mjedis ndrydhës (mbytës), mjedis i zymtë, mjedis sportive (mësimore), mjediset e shtëpisë fshatare, mjediset e fjetjes (e ndenjjes), ngrohja e mjedisëve, ngjyrosja e mjedisëve* etj. Kur është fjala për mjediset e një banese, mund të përdoret edhe fjala **kthinë**, p.sh.: *Shtëpi me tri kthinë* etj.

aneks ~i m. Janë bërë përpjekje që kjo fjalë të zëvendësohet në disa kuptime me fjalën **shtojcë**. Kjo pasqyrohet edhe në FGJSSH, ku kuptimi 3 i

fjalës **shtojcë** është shpjeguar kështu: “Pjesa e kuzhinës e ndarë veçan, që zakonisht shërben për të gatuar dhe për të larë enët: *Kuzhinë me shtojcë; Gatuajnë në shtojcë*”. Me këtë kuptim ka filluar të përdoret më me sukses fjala **përanëse**. Përdorimi i kësaj fjale vetëm me kuptimin e pjesës së kuzhinës të ndarë veçan duhet përkrahur e përgjithësuar. Fjala **shtojcë** e ka zëvendësuar tashmë fjalën **aneks** në gjuhën zyrtare e në terminologjinë juridike, p.sh. **Shtojcë e ligjit (e një vendimi, e një rregulloreje etj.)**. *Libri ka dy shtojca*. Pak a shumë me këtë kuptim ka filluar të përdoret edhe fjala **lidhje**.

anti- — Parashtesë me prejardhje nga greqishtja e vjetër. Ka hyrë në gjuhën shqipe në përbërjen e disa termave të huaj që kanë përdorim ndërkombëtar, p.sh.: **antibiotik, antidemokratik, antidialektik, antifashist, antiimperialist, antikapitalist, antiklerikal, antiparti, antipatriotik, antisizmik** etj. Kjo parashtesë është bërë prodhimtare edhe në fjalë të shqipes. Në disa sosh parashtesa është zëvendësuar e po zëvendësohet, sipas rastit, me parashtesën e shqipes **kundër-**, që e jep të plotë kuptimin e parashtesës **anti-**. Kështu p.sh., përdoret **kundërajror** në vend të **antiajror, kundërlëndë** në vend të **antimaterie** ose **antilëndë, kundërgrimcë** në vend të **antigrimcë** ose **antithërmijë, kundërligjshëm** në vend të **antiligjor, kundërmalarik** në vend të **antimalarik, kundërgaz** në vend të **antigaz, kundërtank** në vend të **antitank, kundërtrup** në vend të **antitrup, kundërhigjienik** në vend të **antihigjienik** etj. siç këshillon edhe FGJSSH. Edhe në një grup fjalësh që ende dalin me parashtesën **anti-**, si p.sh.: **antikombëtar, antifetar, antipopullor, antishkencor, antishqiptar, antizogist** etj., zëvendësimi me parashtesën **kundër-** është i mundshëm dhe po çan udhë, sepse nuk prek kuptimin e fjalës.

anuar, ~i m. Kjo fjale është zëvendësuar fare mirë me fjalën shqipe **vjetar**, p.sh.: **Vjetari statistikor. Vjetar me punime shkencore** etj. Fjala **anuar** është krejt e panevojshme në gjuhën tonë.

apel, ~i m. Kjo fjalë e huaj mund të zëvendësohet me fjalën shqipe **thirrje**. Në FGJSSH te fjala **thirrje** jepet edhe ky kuptim: “Përmendja e emrave të ushtarëve një për një për të parë nëse janë të pranishëm”, p.sh.: **Thirrja e mbrëmjes. Erdhi me vonesë në thirrje**. Kjo mund të shtrihet edhe në praktikën e shkollës. Në vend të: **Bëj apelim. U bë apeli** etj., mund të thuhet fare mirë: **Thërras emrat. U thirrën emrat** etj. Fjala **apel** zëvendësohet me fjalën **thirrje** edhe në kuptime të tjera, p.sh.: **I bëj thirrje dikujt për diçka. Nënshkruan thirrjen. Iu përgjigjën thirrjes** etj. Fjala **apel** përdorej si term i së drejtës, me kuptimin “ankim kundër një vendimi gjyqësor duke kërkuar rishikimin e tij nga një gjykatë më e lartë”. Sot me këtë kuptim ajo është një fjalë e vjetruar dhe si e tillë shënohet edhe në FGJSSH (shih **apel** 2). Në ligjet tona ky veprim quhet thjesht **ankim**.

apikultur/ë, ~a f. Për të zëvendësuar fjalën e huaj **apikulturë**, që e hasim ende aty-këtu në letërsinë tekniko-shkencore, është formuar prej kohësh fjala shqipe **bletari, ~a**. Kështu mund të themi: *Zhvillimi i bletarisë. Sektori i bletarisë.*

aproksimativ, ~e mb., **aproksimativisht** ndajf. Nuk ka asnjë arsye pse të përdoren fjalët e huaja **aproksimativ, aproksimativisht** kur kemi fjalët shqipe **i afërt, i përafërt, afërsisht, përafërsisht, përafërsisht, me përafërsi** që i zëvendësojnë plotësisht ato në kuptimet përkatëse: *Shpenzimet kapën një shumë të përafërt prej 19 750 lekësh. Nga këto të dhëna të përafërta del se sa dëme të mëdha i shkaktohen ekonomisë. Kjo sipërfaqe llogaritet përafërsisht në 463 70 km².*

aprovim, ~i m., **aprovoj** kal., **aprovohet** pës. Prej disa vitesh këto fjalë të huaja janë zëvendësuar me fjalët shqipe **miratim, miratoj** dhe **miratohet**, por ka organe e botime ku ende ndeshen fjalët e huaja. Pra, duhet të themi: **miratimi** i planit, *jap (marr, shpreh) miratimin*, *gjen miratim*, *paraqit për miratim*, *me miratimin e...*, *mbledhja miratoi raportin*, *u miratua nga këshilli shkencor* etj.

asimilim, ~i m., **asimiloj** kal. Për të zëvendësuar fjalët e huaja **asimilim, asimiloj**, si terma të biologjisë janë krijuar neologjizma **përvetim, përvetoj** të cilat kanë filluar të përdoren në librat shkollorë e në letërsinë shkencore, p.sh.: **Përvetimi** i yndyrave varet nga temperatura e shkrirjes së tyre. *E përveton mirë ushqimin. Nuk i përveton dot dhjamërat* etj. Si term i gjuhësisë fjala asimilim është zëvendësuar me neologjizmin **përngjashmim**, p.sh.: **Përngjashmim** i plotë (i pjesshëm). Fjala **asimiloj** përdoret në mënyrë të figurshme edhe me kuptimin “përvetësoj mirë mësimin, fitoj dije e njohuri në mënyrë të shëndoshë, duke i tretur mirë”, p.sh.: *E ka asimiluar mirë mësimin (lëndën)*. Në këtë kuptim, në vend të kësaj fjale të huaj, mund të përdoret fare mirë fjala shqipe **përvetësoj**, p.sh.: *E ka përvetësuar mirë mësimin (lëndën)*. Në zëvendësimin e fjalëve **asimiloj, asimilim** të kihet parasysh dallimi i **përvetoj, përvetim** si terma të biologjisë, nga **përvetësoj, përvetësim**. Shih për këtë edhe FGJSSH te fjalët përkatëse.

asistent, ~i m., **asistoj** jokal. Këto fjalë, kryesisht librore, mund të zëvendësohen mjaft mirë në kuptimin themelor me fjalë shqipe. Kështu, në vend të **asistent** përdoret fjala shqipe **ndihmës: Asistent** i inxhinierit (i profesorit, i regjisorit) — **Ndihmës** i inxhinierit (i profesorit, i regjisorit) etj. Mund të shkohet më tej duke përdorur fjalën **ndihmës** në vend të **asistent** edhe për kuptimin “titull fillestar i atij që merret me punë mësimore në një shkollë të lartë”, pra të thuhet **ndihmës** (ose **ndihmëspedagog**) në universitet, në vend të **asistent** në universitet. Edhe fjala **asistoj** zëvendësohet me fjalët **ndodhem, gjendem, jam i pranishëm, marr pjesë**, p.sh.: *Në mbledhje asistonin edhe... - Në mbledhje ndodheshin edhe... Asistoi në operim - Qe i*

pranishëm në operim. Asistuan shumë veta - Morën pjesë shumë veta etj.

aspekt, ~i m Fjala *aspekt* zëvendësohet në shumicën e kuptimeve e të përdorimeve me fjalët shqipe **pamje, anë, pikëpamje, vështrim**. Kështu, nuk duhet thënë *Aspekte nga jeta (nga puna)* por *Pamje nga jeta (nga puna)*. Në të gjitha *aspektet* — në të gjitha *anët*. E shoh (e marr) në një *aspekt* — E shoh (e marr) në një *vështrim*. Ky është një *aspekt* i luftës së klasave — Kjo është një *anë* e luftës së klasave etj. Kjo fjalë ka mbetur ende në përdorim si term në gjuhësi për kategorinë gramatikore që tregon mënyrën si rrjedh veprimi (*aspekti i kryer ose i pakryer i foljeve*), megjithëse “Fjalori i termave të gjuhësisë” (1975) edhe për këtë kuptim ka këshilluar termin shqip pamje (*aspekti i çastësisë ose pamje e çastësisë, aspekti i kryer ose pamje e kryer etj.*). Me këtë lidhet edhe përdorimi i mbiemrit **aspektiv-e** (*folje aspektive*), po ky përdorim kufizohet në një fushë të ngushtë.

atribuoj kal. Kjo fjalë e huaj, e cila përdoret në gjuhën librore, mund të zëvendësohet fare mirë në kuptimet përkatëse me fjalët shqipe: **vesh, ngjit**. Kështu, në vend të: *I atribuoj një meritë* duhet thënë *I vesh një meritë*. *Ia atribuoj vetes – Ia vesh vetes etj.* P.sh.: *Ju më vishni një meritë më të madhe nga ato që më takojnë me të vërtetë.*

avangard/ë, ~a f. Është përdorur kryesisht në letërsinë politiko-shoqërore me kuptime të figurshme, po tashti është zëvendësuar me **pararojë**: *Avangardë revolucionare — Pararojë revolucionare. Avangardë e organizuar — Pararojë e organizuar. Avangardë e klasës punëtore — Pararojë e klasës punëtore etj.*

avantazh, ~i m. Kësaj fjale i përgjigjet në kuptimin kryesor fjala shqipe **epërsi**: *Avantazh i madh — Epërsi e madhe. Ka avantazh — Ka epërsi. Rriti avantazhin — Rriti epërsinë etj.* *Epërsi* mund të shtihet edhe në disa thënie të terminologjisë sportive, si *Kaloi në avantazh — kaloi në epërsi etj.* Në një kuptim tjetër ajo zëvendësohet me fjalët **përfitim, e mirë**, p.sh.: *Avantazh material — Përfitim material etj.* Nuk sjell ndonjë nuancë kuptimore a ngjyrim emocional të veçantë që të përlligjë sot përdorimin e kësaj fjale.

avash ndajf. Në vend të kësaj fjale bisedore duhet të përdoret ndajfolja **ngadalë** në të gjitha kuptimet: *Ecte avash — Ecte ngadalë. Punon avash — Punon ngadalë. E bën avash — E bën ngadalë; Flet avash — Flet ngadalë; U ngrit avash — U ngrit ngadalë.* Edhe në përdorimet kallëzuesore duhet bërë ky zëvendësim, p.sh: *Avash, se më vrave — Ngadalë, se me vrave. Avash, se e zgjove nga gjumi — Ngadalë, se e zgjove nga gjumi etj.* Me këtë mënyrë duhet zëvendësuar gjithë çerdhja e kësaj fjale, si: **avash-avash — dalëngadalë; avashllëk — ngadalësi; i avashtë — i ngadaltë.**

bajagi ndajf. Është fjalë bisedore me burim nga turqishtja. Përdoret kryesisht në brezin e vjetër në të folmet veriperëndimore, pra ka karakter të

kufizuar krahinor e pothuaj të vjetruar. Në letërsinë e shkruar del pak. Në FGJSSH jepet me referim te ndajfolja **mjaft**, d.m.th. **bajagi** nuk duhet të përdoret më në ligjërimin e zakonshëm; kështu, në vend të **Bajagi i madh** (*i mirë, i rëndë, plak...*) duhet thënë **Mjaft i madh** (*i mirë, i rëndë, plak...*). Edhe në raste të tjera, si: *Ishte rritur bajagi. Ndenji bajagi etj.*, në të cilat afron me ndajfoljen tjetër **goxha**, mund të zëvendësohet me ndajfoljet **mjaft, shumë**.

bazal, ~e mb. Fjalë e huazuar nga gjuhët neolatine. FGJSSH e jep me dy kuptime. Për kuptimin e parë, me përdorim libror, këshillon të përdoret fjala shqipe **themelor**: *Parim themelor. Problem themelor. Ligj themelor. Lëndë themelore*. Si term special me kuptimin e dytë (“që lidhet me bazën, i bazës; që është i vendosur në bazë, që është përkundrejt majës”), vijon ende të përdoret fjala e huaj, por që mund të bëhet **bazor, ~e**, ose të zëvendësohet me **fundor, ~e**. *Sipërfaqe bazore (fundore). Pjesa bazore (fundore). Tumor bazor (fundor) (mjek). Cipëza bazore (fundore) e veshit. Shtresa bazore (fundore)*.

belqim pj. Huazim nga turqishtja. “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” e jep me të drejtë si fjalë tashmë të vjetruar dhe këshillon në vend të saj fjalët **ndoshta, mbase**, që e mbulojnë plotësisht nga kuptimi (**Belqim vjen — Ndoshta vjen. Belqim kthehet — Mbase kthehet etj.**). Herë-herë mund të zëvendësohet edhe me **kushedi, mundet**, p.sh.: **Belqim e kupton vetë — Kushedi (mundet) e kupton vetë. Belqim ashtu mund të jetë — Kushedi, ashtu mund të jetë etj.** Nuk mbart ndonjë ngjyrim emocional ose stilistik si disa fjalë të tjera turke, kështu që mund të përjashtohet krejt nga përdorimi.

berberhan/e, ~ia f. Këtë fjalë me burim nga turqishtja “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” nuk e jep fare, pra e quan jashtë normës letrare dhe e përjashton nga përdorimi. Në tabelat a dyqaneve gjen zakonisht **rrojto**, por edhe **berber** e më rrallë **rrestore, floktore** (më shumë për gra). Në ndonjë fjalor është dhënë për këtë fjalë edhe **berberi, ~a**. Mund të themi se ka fituar tashmë fjala **rrojto** për lokalitë ku qethen e rruhen burrat, kurse **floktore** po përdoret më shumë për lokalitë ku presin e ndreqin flokët gratë. Siç dihet, rrojto lidhet vetëm me **rruaj**, po kjo nuk e pengon që të përdoret në vend të **berberhanes**, me një kuptim më të zgjeruar e të përgjithësuar, pra për lokalitë ku **rruhen** e ku **qethen** burrat. Më tej mund të zëvendësohet edhe fjala **berber**, ashtu siç këshillon FGJSSH: **rrues, ~i** (për burra) dhe **floktar, ~i e floktare, ~ja** (për gra).

bilateral, ~e mb., unilateral, ~e mb. Fjalë librore, që dalin në shkrime shkencore e politiko-shoqërore, shumë herë me vlerë termi. **Bilateral** del në togje të tilla, si: *marrëveshje, marrëdhënie (bisedime) bilaterale, pneumoni bilaterale etj.* E kundërt me të del **unilateral**, po edhe në lidhje të tjera: *detyra unilaterale, pushteti unilateral i burrit, veprim unilateral*. Në këto

kuptime të dyja fjalët janë të zëvendësueshme plotësisht me fjalët shqipe **i dyanshëm, dyanësor** dhe **i njëanshëm, njëanësor**, jo vetëm në përdorimin e përgjithshëm, po edhe në atë terminologjik. P.sh.: *bisedime të dyanshme (dyanësore), pneumoni (ftohje) e dyanshme (dyanësore)* etj. **Bilateral** përdoret ndonjëherë edhe me kuptimin “**reciprok**”, ku, siç dihet, po zëvendësohet me formimin shqip **i ndërsjellë**; pra, *bashkëveprim bilateral* duhet *bashkëveprim i ndërsjellë*.

bina, ~ja *f.* Në kuptimin e saj kryesor kjo fjalë me burim nga turqishtja pothuaj është zëvendësuar me **ndërtesë**. Kështu **Bina e madhe**. *Ngriti një bina*. *Ndreqi binanë* etj. duhet të përdoren **Ndërtesë e madhe**. *Ngriti një ndërtesë* etj. Në të folme të ndryshme ka edhe kuptime të veçanta, si **shtëpi** (p.sh. *I zoti i binasë*), **familje** (p.sh. *Ishte bina e madhe*) etj.; por edhe në këto raste fjala **bina** i ka përgjegjëset e veta më të përgjithshme. Mirëpo kjo fjalë bisedore ka edhe nuanca kuptimore e ngjyime emocionale, që në stile të veçanta kanë vlera karakterizuese. Kështu, thuhet: *Ishte sa një bina*. **Bina nga trupi** etj. sepse **binaja** është përfytyruar si ndërtesë e madhe. Po ashtu fjala **bina** del edhe me kuptimin **fëmijë, trashëgimtar, pasardhës** p.sh.: *Baba pa bina*. *Ishte pa bina*. *Djali ishte binaja e shtëpisë* etj. Edhe në këto raste ka mundësi zëvendësimi të pjesshëm, si: *Baba pa fëmijë*. *Ishte pa pasardhës (pa trashëgimtar)* etj. Më i vështirë është zëvendësimi në disa raste frazeologjike me ngjyrim stilistik e emocional, si p.sh.: *Të shuan binanë* (ka edhe: *Të shuan derën*). *U shoftë me bina! S'iu duk binaja* etj. Përfundimisht kjo fjalë është zëvendësuar në kuptimet e saj kryesore, kurse ndonjë përdorim i veçantë i saj ose njësitë frazeologjike të ndërtuara me të mbeten vetëm brenda kufijve të ndonjë të folmeje ose si mjete me vlerë stilistike (kryesisht në letërsinë artistike).

birinxhi *ndajf.* Fjalë me burim nga turqishtja, që zëvendësohet plotësisht me **bukur** (i), **për bukuri, shumë mirë, s'ka si bëhet me mire, në mënyrë të përsosur, ashtu si duhet** etj. P.sh.: *Kuptonte birinxhi* — *Kuptonte shumë mire*. *Punët shkonin birinxhi* — *Punët shkonin për bukuri (sa s'ka më mirë, për mrekulli...)* etj. Edhe në kuptimin mbiemëror kjo fjalë ka përgjegjësen e saj: **shumë i mire, i dorës së parë, i përsosur** etj. P.sh.: *U bë birinxhi* — *U bë shumë i mirë (u ndreq, u përmirësua)*; *Birinxhi në zanat* — *Shumë i mirë në zanat (i zoti, i përsosur)* etj.

boll *ndajf.*, **bollëk, ~u** *m.* Këto fjalë bisedore nuk janë të nevojshme, sepse kuptimi i tyre mund të jepet fare mirë me fjalë shqipe. Për fjalën **boll** përdoret ndajfolja **mjaft** që mbulon të gjitha kuptimet e saj: *priti boll* — *priti mjaft, ka boll* — *ka mjaft, boll më* — *mjaft më* etj. Ndajfolja **mjaft** përballon kështu edhe kuptimin — **shumë, me shumicë**, që ka fjala **boll** në thënie të tilla, si: *hëngri boll* — *hëngri shumë, ujë boll* — *ujë me shumicë, mirë boll* — *shumë mirë, e bukur boll e bukur shumë* etj. Në përdorimet kallëzuesore

në vend të **boll** përdoret veç **mjaft** edhe **mjafton**. P.sh. **boll**, nuk dua më—**mjafton**, nuk dua më, **boll** që ta kuptojë — **mjafton** që ta kuptojë, **boll** që ta dëgjojë një herë — **mjafton** ta dëgjojë një here etj. Edhe fjala **bollëk** zëvendësohet me fjalët **mbushullim**, **shumicë**, **huri**, **begati**, pra. sipas rastit mund të themi në vend të *gjendet me bollëk* — *gjendet me shumicë*, të prodhojmë *me bollëk* — të prodhojmë *me shumicë*, rruga e **bollëkut** — rruga e **begatisë** (ose e **mirëqenies**), jetojmë *me bollëk* — jetojmë *me begati*. Krahas këtyre duhet zëvendësuar edhe mbiemri **i bollshëm** me fjalët **i mjaftueshëm**, **i shumë**, **i madh**, **i gjerë**, **i pasur** etj. sipas kuptimit që ka fjala në fjalitë përkatëse.

bosh, ~e mb., **boshllëk**, ~u m. Këto dy fjalë zëvendësohen mirë me fjalë shqipe. Kuptimin e fjalës së parë e jep mbiemri **i zbrazët**: *enë boshe* - *enë e zbrazët*, *thes bosh* — *thes i zbrazët* etj. Herë-herë zëvendësohet edhe me **i lirë**, **i pazënë**, si p.sh.: *vend bosh* — *vend i lirë* (*i pazënë*) etj. Në një kuptim tjetër fjala **bosh** zëvendësohet me **i padobishëm**, **pavlerë**, **i kotë**, **i pakuptim** etj., pra: *njeri bosh* — *njeri pa vlerë*, *fjalë boshe* — *fjalë të kota*, *gjëra boshe* — *gjëra të pakuptime*, etj. Për fjalën **boshllëk** përdoret shumë mirë emri shqip **zbrazëti**, por edhe **mungesë**, **e metë**, **mangësi** etj.: *boshllëk i madh* — *zbrazëti e madhe*, *mbushi boshllëkun* — *mbushi zbrazëtinë*, *boshllëqet e nxënësve* — *zbrazëtitë e nxënësve*. ka *boshllëqe* — ka *mangësi*, *ndiente boshllëk* — *ndiente mungesë*, *kam një boshllëk të madh në zemër* — *kam një zbrazëti të madhe në zemër*. Me këtë mënyrë zëvendësohen edhe ndajfolja **bosh** me **zbrazët**, **mangët**. **kot**, **humbur** etj, folja **boshatis** me **zbraz** etj. Edhe në frazeologji ka mundësi zëvendësimi, p.sh.: (*e përcolli*) *me duar bosh* — *me duar thatë* (*zbrazur*), *mbeti me lugë bosh* — *mbeti me lugë zbrazur*, *ngopet me lugë bosh* — *ngopet me lugë zbrazur*. më mirë *djepin bosh* se *shejtanin brenda* — më mirë *djepin thatë...* etj.

bravo pasth. Fjalë e huazuar nga italishtja krejt pa nevojë. Shpreh miratim me entuziazëm. po këtë e jep plotësisht, madje edhe më të fuqishëm, pasthirrma shqipe **të lumtë!** Pasthirrma jonë ka aftësinë të shënojë edhe vetën, së cilës i drejtohet miratimi, me anë të trajtave të shkurtra përemërore që merr: **të lumtë!**, **ju lumtë!**, **u lumtë!**. Me kuptim miratimi, po edhe me një ngjyrim të lehtë keqësues (me inat), kjo pasthirmë përdoret kështu edhe për vetën e parë: **më lumtë që vajta!** Me një shkallë më të ulët force, në vend të pasthirmës **bravo** mund të përdoret edhe **të përgëzoj**. Po ka një përdorim ironik në shprehjen **bravo të qoftë!**, është vështirë të bëhet zëvendësimi i fjalës **bravo**. Megjithatë, edhe në këtë rast mund të përdorim me ironi shprehje të tjera të shqipes, si: *Të shtrëngoju dorën! Nuk e sheh, punë të mirë na paske bërë!* etj.

brazdë, ~a f. Në vend të kësaj fjale përdoret **hulli**, një fjalë e bukur popullore. Kështu, **Brazdë e thellë** — **Hulli e thellë**. *Brazdat e parmendës* —

Hullitë e parmendës. Ujitje me **brazda** — Ujitje me **hulli** etj. Në një kuptim fjala **brazdë** zëvendësohet, përveç me **hulli**, edhe me **rrudhë** (*Brazdat e ballit* — *Rrudhat e ballit* etj.), kurse në kuptim të figurshëm me **mbresë** (*Brazdë e pashlyeshme* — *Mbresë e pashlyeshme*). Fjala **hulli** gjen përdorim edhe në disa njësi frazeologjike, si p.sh.: *Erdhi (ra) në brazdë* — *Erdhi (ra) në hulli* etj.

brumatriç/e, ~ja f. Kjo fjalë me prapashtesë të huaj (nga italishtja) është zëvendësuar me fjalën **brumëgatuese**, që e ka edhe FGJSSH, p.sh.: *Laj brumëgatuesen*. U prish *brumëgatuesja*.

bujrum *pasth.* Kjo fjalë, e huazuar nga turqishtja, ndeshet rrallë në ligjërimin bisedor, kryesisht te brezi i moshuar, për të ftuar dikë që të hyjë në shtëpi, të ulet për të nderjur a për të ngrënë etj. Kjo fjalë e huaj mbulohet me pasthirmën e shqipes **urdhëro (ni)!**, p.sh. *A do miq, o i zoti i shtëpisë?* — *Urdhëro(ni)!* — *iu përgjigj plaku.* — *Ju bëftë mire!* — *thotë.* — *Urdhëro(ni)!* — *thonë këta.*

celul/ë, ~a f., **celular, ~e** mb. Këtë fjalë e mbulon plotësisht fjala shqipe **qelizë**, si në fushën e biologjisë, ku përdoret si term, ashtu edhe në kuptime të tjera. Kështu, në vend të: **celulë** *shtazore (bimore)* duhet thënë **qelizë** *shtazore (bimore)*, **bërthama (ndarja)** e **qelizës**, për *shumëzimi i celulave* përdoret *shumëzimi i qelizave*. Po kështu, në kuptim të figurshëm thuhet *në çdo qelizë të ekonomisë, familja është qeliza bazë e shoqërisë* etj., duke mënjanuar përdorimin e fjalës **celulë**. Edhe si term në fushën e muzikës **celulë** zëvendësohet me fjalën shqipe **bulëz**, një fjalë e bukur popullore. Por fjala **celulë** do të përdoret si term në fushën politiko-shoqërore për *organizatën-bazë* të Partisë Komuniste të Shqipërisë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare dhe në vitet e para pas çlirimit, si edhe për njësinë më të vogël organizative të Rinisë Komuniste të Shqipërisë. Fjala **celular**, që përdoret kryesisht në biologji, zëvendësohet me **qelizor**, (*lëngu, indi*) **celular** — (*lëngu, indi*) **qelizor** etj.

centigrad/ë, ~a f., *sh.* **~ë, ~ët**. Fjalë e huazuar nga gjuhët neolatine. E ka edhe FGJSSH si term special me kuptimet: 1) “një e qindta pjesë e gradës”; 2) “që është i ndarë në njëqind gradë, që ka njëqind nëndarje” (për shkallën e termometrave dhe gradët e këndeve gjeometrike). Për kuptimin e dytë FGJSSH këshillon të përdoret në vend të saj fjala shqipe **njëqindgradësh, ~e**, p.sh.: *Termometër njëqindgradësh*. Shkallë *njëqindgradëshe*.

cerebral, ~e mb. Është fjalë e huaj që ka hyrë në gjuhën shqipe nga gjuhët neolatine dhe përdoret kryesisht si term në fushën e anatomisë. Kuptimin e kësaj fjale e mbulon mbiemri shqip **trunor, ~e**, dhe rasa gjinore e emrit **tru, ~ri**, p.sh.: *Cipa (korja) trunore (e trurit)*. *Nerv trunor (i trurit)*. *Tumor trunor (i trurit)*, por edhe *Hemorragji trunore (e trurit)*.

cirkuit, ~i m. sh. **~e**, **~et**. Term i huazuar nga gjuhët neolatine. E ka edhe FGJSSH, por në vend të tij këshillohet të përdoret fjala shqipe **qark**. P.sh.: *Qark i shkurtër. Qark i jashtëm (i brendshëm). Mbyll (hap, ndërpres) qarkun.*

civilizim, ~i m., **civilizoj** kal., **civilizuar** (i, e) mb. Këto fjalë janë zëvendësuar plotësisht me fjalët me përdorim të gjerë **qytetërim**, **qytetëroj**, **i qytetëruar**, prandaj duhen mënjeluar gjithkund. Kështu, në vend të **civilizimi** shqiptar duhet thënë **qytetërimi** shqiptar, komb (popull, vend) **i civilizuar** — komb (popull, vend) **i qytetëruar** etj. Fjalët **qytetërim**, **qytetëroj**, **i qytetëruar** jo vetëm i mbulojnë plotësisht nga kuptimi e përdorimet fjalët **civilizim**, **civilizoj**, **i civilizuar**, por kanë përmbajtje edhe më të gjerë, si p.sh.: “*njeri i qytetëruar*”, *njeri i edukuar*” (përdorime ironike). Rrjedhimisht edhe fjalët e tjera të prejardhura zëvendësohen paralelisht, pra, folja vetvetore **civilizohem** me **qytetërohem**, mbiemri **civilizues** me **qytetërues** etj.

decidoj kal. Kjo fjalë e huaj, me prejardhje nga gjuhët neolatine, (fr. *decider*, ital. *decidere*) ndeshet ende aty-këtu. Në vend të saj mund të përdoret folja **vendos**, që e mbulon fare mirë fjalën e huaj në të gjitha kuptimet. Kështu, mund të thuhet: *Vendosën të ruhet status quoja. Vendos për zgjidhjen e problemit. Faktorët që vendosin më shumë për ngritjen e rendimentit të punës. Nuk vendos dot etj.*

deciziv, ~e mb. Fjala e huaj **deciziv**, me prejardhje nga gjuhët neolatine (fr. *décisif*, *décisive*, ital. *decisivo*), mund të zëvendësohet plotësisht nga fjala shqipe **vendimtar**. p.sh. *Faktorët vendimtarë të fitores sonë. Ndeshjet vendimtare. Vit vendimtar. Çast vendimtar. Ndërrhyrje vendimtare. Rol vendimtar. Prova vendimtare* etj. Nuk ka asnjë arsye që në shembujt e mësipërm të përdoret fjala e huaj **deciziv** në vend të fjalës shqipe **vendimtar**. (Fjala **deciziv** ka edhe këto kuptime: prerazi; ashpër (i, e), mprehtë (i, e); në drejtësi **deciziv**, ~i (lat. *decisio*) ka kuptimin e vendimit gjyqësor veçanërisht për raste të dyshimta MD).

dedikoj kal., **dedikohet** pës., **dedikim**, ~i m. Në vend të këtyre fjalëve të huaja me prejardhje nga gjuhët neolatine (ital. *dedicare*, fr. *dédicacer*, lat. *dedicatio* MD), ka kohë që po përdoren fjalët shqipe **kushtoj**, **kushtohet**, **kushtim**. Megjithatë jo rrallë ndeshen në përdorim edhe fjalët e huaja të mësipërme, prandaj duhet treguar më shumë kujdes për t'i mënjeluar ato plotësisht. Ja disa shembuj të përdorimit të fjalëve shqipe: (i) **kushtoj**, (i) **kushtohet**, **kushtim** në vend të fjalëve të huaja (i) **dedikoj**, (i) **dedikohet**, **dedikim**: *Librin ia fali shokut me një kushtim të thjeshtë. Ky monument (duhet përdorur përmendore MD) u kushtohet partizanëve. Poemën e parë ua ka kushtuar shokëve të fëmijërisë etj. Herë-herë fjalët (i) **dedikoj**, (i) **dedikohet** përdoren gabimisht në vend të fjalëve (i) **detyroj**, (i) **detyrohet**, p.sh. *Sukseset e arritura i dedikohen punës së palodhur të punonjësve... —**

duhet **i detyrohen** punës së palodhur... (fjala **dedikim** ka edhe këto kuptime: falje, dhurim, lënie me testament MD).

definicion.~i. *m.* Kjo fjalë e huaj ka hyrë në gjuhën shqipe nga frëngjishtja e italishtja (fr. *definition*, ital. *definizione*). Për ta zëvendësuar atë prej kohësh është krijuar e po përdoret fjala përkufizim, p.sh.: **Përkufizim shkencor**. **Përkufizim i gjatë** (i shkurtër). **Përkufizimi i materies**. **Përkufizimi i foljes** etj. Fjala e huaj **definicion** është krejt e panevojshme dhe duhet mënjanuar përfundimisht nga gjuha jonë.

definitiv, ~e *mb.*, **definitivisht** *ndaj*. Fjala **definitiv** ka hyrë në gjuhën shqipe nga frëngjishtja e italishtja (fr. *définitiv*, *définitive*, ital. *definitivo*, lat. *definitivus* MD), ndajfolja **definitivisht** është formuar brenda shqipes me prapashtesën **-isht**. Kuptimin e mbiemrit **definitiv** e jep fare mirë fjala shqipe **përfundimtar**, p.sh.: *Vendim përfundimtar*. *Përgjigje përfundimtare*. *Zgjidhje përfundimtare*. *Varianti përfundimtar* etj.

demarsh, ~i *m.* Ka hyrë në shqipen nga frëngjishtja. Është përdorur më shumë në publicistikë. Kuptimin e saj “Përpjekje që bëhet për t’i rënë prapa një pune ose për të arritur diçka, duke ndërhyrë te dikush, duke folur me dikë për t’i mbushur mendjen etj.” e jep plotësisht fjala shqipe **përçapje**, p.sh.: *Bën përçapje të reja*. *I vajtën kot të gjitha përçapjet*.

destinim, destinoj (mungon një faqe MD) Kur është fjala për diçka të lënë për një qëllim ose të ndarë për një punë, në vend të **i destinuar** mund të përdoret mbiemri **i caktuar**, p.sh.: *Goma të caktuara për t’u prerë*. *Lahet në banja të caktuara për këtë punë*. *Prodhuesit e domates nuk duhet ta lënë në dorë të dytë prodhimin e caktuar si lëndë të parë për kombinatin*. *Lista e mallrave të caktuara për në portin e Durrësit*. *Fara e fasules së prekur, që është caktuar për mbjellje, të trajtohet me hezaktorin* etj.

detaj, ~i *m.* Kjo fjalë, që vjen nga frëngjishtja *détail*, ka filluar të zëvendësohet mjaft mirë me fjalën shqipe **hollësi**, p.sh.: *Shkrimtari ka gjetur hollësi të tilla, që i tipizojnë mirë personazhet*. *Përdorimi me vend i hollësive artistike*. *Teknika duhet njohur deri në hollësitë më të imëta*. *Pa hyrë në hollësi të tepërta* etj. Në vend të fjalës së huaj **detaj** mund të përdoret disa herë edhe fjala **imtësi**, p.sh.: *Imtësitë e ngjarjes (e përshkrimit)*. *Ia zbërthen me imtësitë më të vogla* etj.

detajoj kal., detajohet pës., detajim, ~i *m.* Edhe këto tri fjalë mund të zëvendësohen mirë me fjalë shqipe. Kuptimin e tyre e japin fjalët **përimtoj, përimtohet. përimtim** (ose **imtoj, imtohet, imtim**), p.sh.: *Ministria e Bujqësisë i merr ato dhe i përimton për çdo rreth*. *Do të dërgohet ekipi për të përimtuar planet e çdo kooperative*. *Lind nevoja e përimtimit të detyrave për çdo sektor*. *Përimtimi i detyrave*. **Përimtimi i p!aneve** etj. Edhe kuptimet e mbiemrit prej pjesor **i (e) detajuar** mbulohen plotësisht nga mbiemri **i**

përimtuar (ose **i imtuar**), p.sh.: *Grafik i imtuar* i punimeve. Të shënohen në një formë më të **përimtuar** planet ditore. Në këtë formular paraqiten në mënyrë të **imtuar** si shpenzimet ashtu edhe të ardhurat etj.

determinoj kal., **determinohet** pës., **determinim**, **~i** m., **determinant**, **~e** mb., **determinues,—e** mb. Këto fjalë te huaja kanë hyrë në gjuhën shqipe nga italishtja *determinante*, *determinare* e nga frëngjishtja *déterminant*, *déterminer* (lat. *determinatus*, *determinatio*, *determinare* MD). Në vend të tyre kanë filluar të përdoren gjerësisht, sipas rastit, fjalët shqipe **përcaktoj**, **përcaktohet**, **përcaktim**, **përcaktues**, **vendimtar**. Ja disa shembuj: **Përcaktuan** fitoren. Pjekja është një nga faktorët më kryesorë që **përcakton** cilësinë e mirë të rrushit. Faktorë **përcaktues**. Rol **vendimtar** etj. Folja **determinoj** mund të zëvendësohet edhe me shprehjen **luan rol vendimtar**, p.sh.: *Fillimi i mirë i setit të parë luajti rol vendimtar në zhvillimin e krepit ndeshjes*. (ky grup fjalësh **ka** edhe këto kuptime: kufizim, ngushtim, reduktim, caktot, vendos, forcoj etj. MD)

devijoj kal. e jokal., **devijim**, **~i** m. Folja **devijoj** ka hyrë në gjuhën shqipe nga italishtja e frëngjishtja (ital. *deviare*, fr. *dévier*). që vijnë nga latinishtja *deviare* (“dal nga rruga”). Nga folja **devijoj** është formuar në gjuhën shqipe emri **devijim**. Këto fjalë të huaja mund të zëvendësohen mirë në shumicën e kuptimeve e të përdorimeve me fjalët shqipe **shmang**, **shmangem**, **shmangie**, p.sh.: *Nuk ka forcë që të na shmangë nga rruga jonë. Era e shmangu anijen nga perëndimi. Nuk shmanget nga parimet. Shmangia e gjilpërës magnetike. Shmangie nga drejtimi. Shmangie nga e majta (nga e djathta) etj.* Edhe “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” për kuptimet e fjalëve **devijoj**, **devijim** e drejton lexuesin përkatësisht te fjalët **shmang**, **shmangem**, **shmangie**. Kuptimin e foljes **devijoj** në disa raste e japin mirë shprehjet **largohem (a dal) nga udha** (kur përdoret si jokalimtare) dhe **largoj nga udha, nxjerr nga rruga** (kur përdoret si kalimtare).

dezhurn, **~i** m. Kjo fjalë e ka burimin te frëngjishtja “*de jour*” – “*i ditës*” (d.m.th. që ka radhën e shërbimit atë ditë). Trajta **dezhurn** ka hyrë në gjuhën tonë nga rusishtja *dezhurnij*. Përdoret me dy kuptime. Së pari, **dezhurn** përdoret në kuptimin “ai që ka radhën për të kryer disa shërbime të caktuara në një ndërmarrje a institucion”. Në këtë kuptim fjala **dezhurn** ka filluar të zëvendësohet me togfjalëshin **nëpunës i shërbimit**, por në vend të saj mund të përdoret edhe neologjizma **ditor~i**, p.sh.: *Ditori i ndërmarrjes. Kush është ditor sot?* Së dyti, fjala **dezhurn** përdoret nganjëherë edhe në kuptimin “shërbimi që kryhet në një ndërmarrje a institucion nga punonjësit e saj në ditë të caktuara e sipas një radhe të caktuar”. Në këtë rast, në vend të saj, duhet përdorur togfjalëshi **shërbim ditor** ose thjesht, fjala **shërbim**. Kështu duhet të themi: *Kam (bëj, kryej, marr) shërbimin ditor* dhe jo *dezhurnin*.

deziluzion, ~i m., **deziluzionoj** kal., **deziluzionohem** vetv. Kjo fjalë librore e huazuar nga frëngjishtja (*désillusion*) është përdorur më shumë në letërsinë politiko-shoqërore. Vendi e saj po e zë tashmë fjala shqipe **zhgënjim**, e cila ka gjetur përhapje të gjerë, p.sh.: *Adnani ngriti supet. Shpresa e kuptoi: më tepër se dyshim, ai gjest shprehte një zhgënjim të thellë*. Edhe për fjalët e tjera që janë formuar nga tema e kësaj fjale, si **deziluzionoj**, **deziluzionohem**, i **deziluzionuar** kemi fjalët e gjuhës sonë **zhgënjëj**, **zhgënjehem**, i **zhgënjyer**, të cilat mbulojnë plotësisht kuptimet e fjalëve të huaja të mësipërme. Për kuptimet e përdorimet a tyre shih FGJSSH

difezë, ~a, f., **difensiv**, ~e mb. Fjala **difezë**, e huazuar nga ital. *difesa*, është përdorur në terminologjinë ushtarake e sportive. Ajo është zëvendësuar fare mirë me fjalën shqipe **mbrojtje**, p.sh.: *Sistemi i mbrojtjes. Mënyrat e mbrojtjes. Mbrojtja e skuadrës mike* etj. Siç shihet, fjala **difezë** është krejt e panevojshme në gjuhën tonë. Edhe mbiemri **difensiv**, i cili është përdorur kryesisht në terminologjinë ushtarake, sot është zëvendësuar me fjalën shqipe **mbrojtës**. p.sh.: *Veprim (luftim) mbrojtës* dhe jo *Veprim difensiv* etj. Ky zëvendësim duhet të shtrihet edhe në emërtimet Armë **difensive**. *Raketë difensive* duke i quajtur Armë (raketë) **mbrojtëse**.

difuzion, ~i m. Kjo fjalë ka hyrë në gjuhën tonë nga italishtja *diffusione* e nga frëngjishtja *diffusion*. Ajo është përdorur për mjaft kohë si term i fizikës, por sot në tekstet shkollore është zëvendësuar me fjalën shqipe **shpërhapje**. Siç shpjegohet në FGJSSH, ky term përdoret me dy kuptime: 1. Depërtim i dyanshëm i molekulave a i atomeve të një trupi (sidomos të lëngët a të gaztë) midis molekulave a atomeve të një trupi tjetër me të cilin është në kontakt (p.sh.: *Shpërhapja e lëngjeve(e gazeve). Koeficienti i shpërhapjes*). 2. Përhapja e rrezeve të dritës që kalojnë nëpër një trup të tejdukshëm ose që bien në një sipërfaqe jopasqyruese në të gjitha drejtimet (p.sh. *Shpërhapja e rrezeve të dritës*). Fjala shqipe **shpërhapje** i jep fare mirë kuptimet e fjalës së huaj **difuzion**, e cila nuk duhet të përdoret më. Në gjuhën shqipe është përdorur edhe fjala e përbërë **radiodifuzion**, e cila është zëvendësuar me **radiopërhapje**, p.sh.: *Radiopërhapja shqiptare Qendra (drejtoria) e radiopërhapjes*.

dimension, ~i m. Kjo fjalë, e huazuar nga italishtja *dimensione* e nga frëngjishtja *dimension*, është shqipëruar prej kohësh me fjalën **përmasë**. “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” na këshillon që në vend të fjalës **dimension** të përdoret fjala **përmasë**, me të dyja kuptimet e saj: 1. Shtrirja e një trupi në gjatësi e në gjerësi ose në lartësi; madhësia e diçkaje, e matur në kufijtë e vet, p.sh.: *Përmasat e dhomës (e shtëpisë, e godinës). Tri përmasat e trupave të ngurtë. Me përmasa të mëdha (të vogla)*. 2. fig. Shkalla e zhvillimit ose madhësia që ka arritur një gjë a një dukuri; **përpjesëtim**. p.sh.: *Përmasat e zhvillimit ekonomik (shoqëror, kulturor). Ka marrë përmasa të gjera*. Siç shihet nga këta shembuj, fjala **përmasë** i mbulon fare mirë kuptimet e fjalës

së huaj *dimension*, e cila nuk duhet përdorur.

direkt, ~e mb., direkt ndajf. Këto fjalë të huaja kanë hyrë në shqipen nga gjuhët neolatine. Për mbiemrin *direkt, ~e* në shqipen përdoret fjala **drejtpërdrejtë**, p.sh.: *Lidhje e drejtpërdrejtë. Pjesëmarrje e drejtpërdrejtë. Përgjigje e drejtpërdrejtë. Në mënyrë të drejtpërdrejtë.* Për ndajfoljen *direkt* në shqipen përdoren fjalët **drejtpërdrejt, drejtpërsëdrejti** ose **drejt**, p.sh.: *Ndihmoi (ndikoi) drejtpërdrejt. E pyeti drejtpërdrejt. E sqaroi drejtpërdrejt. Nga fabrika (kooperativa) drejtpërdrejt te blerësi.*

distanc/ë, ~a f. Fjalë e huaj që ka hyrë në gjuhën shqipe nga gjuhët neolatine. Jepet edhe në FGJSSH. Në gjuhën tonë kjo fjalë zëvendësohet fare mirë me fjalët **largësi** e **largesë**, p.sh.: *Largësia në mes dy vendeve. Largësi e madhe. Garat e largësive. Mbjellja me largësi të barabartë. Përshkoi largësinë. Mat largesën* etj.

distik mb. Kjo fjalë e huaj, me temë nga gjuhët neolatine, përdoret si term në fushën e botanikës dhe të bujqësisë në togun **elb distik**. Shërben për të përcaktuar një lloj elbi, i cili e ka kallirin me dy radhë a rreshta kokrrash dhe përdoret kryesisht për prodhimin e birrës. Siç e dëshmon edhe FGJSSH, është zëvendësuar me fjalët shqipe **dyrreshtor** ose **dyradhësh**, që e mbulojnë plotësisht kuptimin e saj: *Elb dyrreshtor* (ose *dyradhësh*).

divergjenc/ë, ~a f. Fjalë e huaj që ka hyrë në gjuhën shqipe nga gjuhët neolatine. E ka edhe "Fjalori i gjuhës së sotme shqipe". Kuptimi kryesor i kësaj fjale është "mospërputhje e mospajtimit në mendime dhe në veprime ndërmjet dy a më shumë njerëzve, ndryshim mendimesh a pikëpamjesh për një çështje, mosmarrëveshje". Në këtë kuptim kjo fjalë zëvendësohet me fjalët e shqipes **mospajtimit, mosmarrëveshje, mospërputhje**. P.sh.: *Mospajtimit teorik. Mosmarrëveshje ideologjike (politike). Kanë mosmarrëveshje. Kemi mospërputhje mendimesh* etj.

divorc, ~i m., divorcoj kal., divorcohem vetv., divorcim, ~i m., divorcuar (i, ë) mb. Fjala **divorc** ka hyrë në gjuhën shqipe nga italishtja nëpërmjet gjuhës së shkruar. FGSSSH e ka këtë fjalë, por nuk e shpjegon dhe e çon te fjala shqipe **ndarje**, që përdoret në mbarë gjuhën dhe te togfjalëshi **zgjidhje e martesës**, që përdoret në ligjërimin libror e zyrtar. Kështu e ka edhe "Kodi i familjes" P.sh.: *E drejta e ndarjes (e zgjidhjes së martesës). Bëri (kërkoj) ndarjen (zgjidhjen e martesës).* Edhe fjalët **divorcoj, divorcohem, divorcim, divorcuar** (i, e), që janë formuar brenda shqipes, zëvendësohen përkatësisht nga fjalët dhe togfjalëshat: **ndaj, ndahem, zgjidh martesën; ndarje, zgjidhje e martesës; i ndarë**, p.sh.: *U ndanë. Zgjidhën martesën. Ndarja (zgjidhja e martesës) nuk u miratua. Është i ndarë.*

dominoj kal., dominim, ~i m., dominues, ~e mb. "Fjalori i gjuhës së sotme shqipe" nuk i ka këto fjalë. Fjala **dominoj** ka hyrë në gjuhën tonë nga

gjuhët neolatine, pastaj janë formuar rrjedhojat e saj brenda shqipes. Ajo ka kuptimin **zotëroj, sundoj** dhe zëvendësohet fare mirë me këto dy fjalë të gjuhës sonë, të cilat i mbulojnë plotësisht kuptimet e përdorimet e saj. Ja disa shembuj: *Për 15 minuta me radhë zotëruan* (në vend të: **dominuan**) *vendësit. Me zërin e tij të fuqishëm zotëroi* (në vend të: **dominoi**). *Nuk e zotëron* (nuk e ka në dorë) *situatën* (në vend të: nuk e **dominon**). *Lufta e superfuqive për të sunduar botën fln.* (në vend të: për të **dominuar**); *Kudo sundon një frymë e luftës revolucionare* (në vend të: **dominon**) etj. Edhe fjalët e prejardhura **dominim, dominues** zëvendësohen me **zotërim, sundim, zotërues, sundues**, p.sh.: *Lufta për sundimin e deteve* (në vend të: **dominimin**). *Pikë sunduese ose zotëruese* (në vend të: **dominuese**) etj.

dubël mb. dhe *ndajf.* Fjalë e huaj që përdoret si mbiemër e si ndajfolje. Ka hyrë në gjuhën shqipe nga frëngjishtja. FGJSSH nuk e ka këtë fjalë, sepse në vend të saj kemi fjalë të shqipes. Si mbiemër ka kuptimin “që përbëhet nga dy pjesë, nga dy fije etj. të njëjta ose të ngjashme”; në këtë kuptim ajo zëvendësohet me fjalët shqipe **dyfishtë** (i, e), **dyfish, ~e**, p.sh.: *Tel i dyfishtë. Faqe dyfishe. Lidhje dyfishe. Garanci dyfishe.* Si ndajfolje përdoret me kuptimin “edhe një herë aq sa është; dy herë më shumë; më dysh”; me këtë kuptim zëvendësohet me ndajfoljen shqipe **dyfish**. p.sh. *E bëri dyfish.*

eksiq ndajf. dhe *mb.* “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” e çon te fjala **metë, mangët** dhe **metë** (i, e), **mangët** (i, e). Është fjalë me prejardhje nga turqishtja dhe, si shumë turqizma të tjerë, përdoret kryesisht në ligjërimit bisedor. Në vend të këtij huazimi të panevojshëm mund të përdoren fare mirë fjalët e lartpërmendura shqipe, të cilat mbulojnë si kuptimin e drejtpërdrejtë, ashtu edhe kuptimin e figurshëm të kësaj fjale. P.sh.: *Ia dha metë (mangët). Thesi doli dy kilogramë metë. Është i metë (i mangët) nga trutë (nga mendtë).*

eksperienc/ë ~a f. Që në kohën e Rilindjes, për herë të parë nga Petro Nini Luarasi, me kuptimin e fjalës së huaj **eksperiencë** u përdor fjala shqipe **përvojë**, e cila tashmë e ka zëvendësuar shumë mirë atë, p.sh.: *Përvojë e pasur. Njeri me përvojë. Përvojë e luftës revolucionare. Ai ka përvojë në këtë punë. Atyre nuk u mungon përvoja. Ato shkëmbejnë përvojë. Mbështeten në përvojën e të përparuarve* etj.

eksplozion, ~i m., eksploziv, ~e mb. Këto fjalë kanë hyrë në gjuhën shqipe nga gjuhët neolatine. I ka edhe “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe”. Fjala **eksplozion** zëvendësohet mirë në gjuhën tonë me fjalët **plasje** e **shpërthim**, që e mbulojnë plotësisht kuptimin e saj, p.sh.: *Plasje e fuqishme. Plasje e bombës. Shpërthim i gazit. Plasjet (shpërthimet) e bombave.* etj. Mbiemri **eksploziv** zëvendësohet gjithashtu me fjalët **plasës, shpërthyes**, p.sh.: *Lëndë plasëse. Gaz plasës. Bashkëtingëllore shpërthyes* etj. Edhe emri **eksploziv**, që ka kuptimin “lëndë e posaçme plasëse a shpërthyes” (“Fjalori i

gjuhës së sotme shqipe”), zëvendësohet me togfjalëshin **lëndë plasëse**, p.sh.: *Rregulla për ruajtjen dhe transportimin e lëndëve plasëse* (në vend të: *e eksplozivit*); *E hodhën në erë me lëndë plasëse* (në vend të: *me eksploziv*) etj.

ekspresiv *mb.* Kjo fjalë e huaj neolatine me kuptimin “që e shpreh diçka bukur, qartë e në mënyrë të gjallë”, nuk jepet në FGJSSH. Ajo zëvendësohet fare mirë në gjuhën tonë me mbiemrin **shprehës, ~e**, p.sh.: *Fjalë shprehëse. Mjete shprehëse. Sy shprehës. Lexim shprehës* etj. Emri **ekspresivitet**, që lidhet me mbiemrin **ekspresiv**, zëvendësohet fare mirë me fjalën e re **shprehësi**, e cila jepet në FGJSSH, p.sh.: *Shprehësi e theksuar. Flet me shprehësi*. Krahas kësaj fjale mund të përdoren, ne raste të përshtatshme, edhe togjet **fuqi shprehëse, aftësi shprehëse**.

ekstrem, ~i m., ekstrem, ~e mb. “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” ka vetëm mbiemrin. Në gjuhën shqipe kuptimin e fjalës **ekstrem**, kur përdoret si emër, e jep mirë fjala **skaj**; kur përdoret si mbiemër, fjalët **i skajshëm, i tejtmë** dhe si term edhe **skajor**. Ja disa shembuj: *Skaji lindor. Nga të dy skajet. Nga një skaj te tjetri. Në kufirin e skajshëm. Raste të skajshme. Masa të skajshme. Pikëpamje të skajshme. Në cakun (skajin) më të tejtmë. Shkalla me e tejtmë.* etj. Edhe termi **ekstremitet**, që përdoret nganjëherë në anatomi në kuptimin e gjymtyrëve të trupit, është një fjalë e huaj e panevojshme. Ai zëvendësohet me fjalët shqipe **gjymtyrë** ose **anësi**, p.sh.: *Gjymtyrët e sipërme. Anësitë e poshtme* etj.

ekuilibër, ri m. Kjo fjalë me burim nga gjuhët neolatine mund të zëvendësohet me fjalën **baraspeshë** (në fizikë, kimi), p.sh.: *Baraspeshë e forcave. Baraspeshë e qëndrueshme (e paqëndrueshme). Baraspesha e një lëngu (e një trupi të ngurtë)* etj. Kjo fjalë është dhënë edhe në FGJSSH. Nga fjala **ekuilibër** në gjuhën shqipe janë formuar edhe fjalët: **ekuilibroj, ekuilibrim, çekuilibroj, çekuilibrohem, çekuilibrim**. Fjala **ekuilibroj** zëvendësohet, sipas rastit, me fjalët **baraspeshoj e drejtpeshoj** (shih për këtë edhe “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe”). Fjala **ekuilibrim** zëvendësohet me **drejtpeshim**, që përdoret kur duam të shprehim një gjendje mendore e psikike normale të një njeriu, kur ai gjykon e mendon në mënyrë të mirë, p.sh.: *Drejtpeshim mendor. I mungon drejtpeshimi.* etj. Fjala **drejtpeshim** përdoret edhe në fushën e fizikulturës: *Ushtrime në trarin e drejtpeshimit. Mban (ruan) drejtpeshimin. Vë në drejtpeshim* etj.

ekuivalnc/ë, a f. Kjo fjalë nuk jepet në FGJSSH. Ajo ka hyrë në gjuhën tonë nga gjuhët neolatine dhe mund të zëvendësohet fare mirë me fjalën shqipe **barasvlerë**.

ekuivalnt, ~e mb., ekuivalnt ~i m. Këto dy fjalë me burim nga gjuhët neolatine jepen edhe në FGJSSH. Ato zëvendësohen fare mirë me fjalët shqipe **i barasvlershëm dhe barasvlerës**, p.sh.: *Madhësi të barasvlershme.*

Pjesë të barasvlershme. Paraja si barasvlerës i përgjithshëm. etj. Në disa fjalorë terminologjikë të shkencave të natyrës fjalët **ekuivalent, ~e, ekuivalent, ~i** dhe **ekuivalenc/ë, ~a** janë shqipëruar përkatësisht me **i njëvlershëm, njëvlerës, ~i** dhe **njëvlerësi, ~a**, p.sh.: *Figura të njëvlershme. Shprehje të njëvlershme. Njëvlerës algjebrik (kimik, fizik). Marrëdhënie njëvlerësie.* Këto fjalë janë përfshirë e janë shpjeguar edhe në FGJSSH.

ekzagjeroj kal, ekzagjerim, ~i m., ekzagjeruar (i, e) *mb.* “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” nuk i ka këto fjalë. Folja **ekzagjeroj**, fjalë e huaj me burim nga gjuhët neolatine, ka kuptimin “e paraqit diçka duke i dhënë përmasa më të mëdha a një rëndësi më të madhe se ç’ka në të vërtetë, e kaloj masën në përshkrimin a paraqitjen e diçkaje”. Ajo zëvendësohet kryesisht me **(e) teproj** dhe **(e) zmadhoj** (zakonisht kur në fjali ka një kundrinë të drejtë të shprehur me emër). Ja disa shembuj: *Mund të themi pa e tepruar se... E zmadhon rrezikun. I zmadhon meritat.* etj. Edhe fjalët e prejardhura **ekzagjerim, ekzagjeruar** (i, e) zëvendësohen përkatësisht me **teprim, tepruar** (i, e); **zmadhim, zmadhuar** (i, e), p.sh.: *Teprime të panevojshme. Ka mjaft zmadhime. Humor i tepruar.* etj.

ekzekutoj kal., ekzekutohem pës., ekzekutim, ~i m., ekzekutues, ~e mb. Kjo çerdhe fjalësh gjendet edhe në FGJSSH. Kuptimi i foljes **ekzekutoj** shprehet fare mirë me fjalë të shqipes, si: **zbatoj, përmbush, vë në jetë diçka** (një ligj, një vendim, një urdhër); **luaj** (një vepër muzikore), **bëj** (ushtrime gjimnastikore). Prandaj kjo fjalë dhe çerdhja e saj mund të zëvendësohen me fjalët e mësipërme e rrjedhojat e tyre, p.sh.: *Nëpunës zbatues. Zbatues i ligjit. Zbatoj vendimin. Luaj në piano. Bëj ushtrime gjimnastikore.*

elkizgjent, ~e mb. Kjo fjalë e huaj, të cilën si të tillë nuk e jep “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe”, zëvendësohet fare mirë me fjalën shqipe **kërkues**, p.sh.: *Ai është shumë kërkues ndaj vetes. Duhet të jemi më kërkues.* etj.

ekzistenc/ë, ~a f., ekzistoj jokal. Fjalë të huaja, të huazuara nga gjuhët neolatine. Jepen edhe në FGJSSH. Emri **ekzistencë** përdoret me kuptimin “qenia në jetë e diçkaje, qenie, jetesë” dhe mund të zëvendësohet fare mirë me këto fjalë të shqipes. P.sh.: *Të qenët e botës* (në vend të: **ekzistenca**). *Mjetet që kemi ase që janë* (në vend të: **që ekzistojnë**). *Luftë për jetën* (në vend të: **për ekzistencë**). Folja **ekzistaj** mund të zëvendësohet me fjalët e shqipes **jam, jetoj**, p.sh.: *Janë kushtet* (në vend të: **ekzistojnë**). *Nuk jeton më* (në vend të: **ekziston**). Pra, kjo fjalë e huaj dhe rrjedhojat e saj mund të mënjanohen duke përdorur në vend të tyre sipas rastit fjalët shqipe **qenie, jetesë, jetoj**.

eliminohet kal., eliminohem pës., eliminim, ~i m. Edhe këto fjalë me burim nga gjuhët neolatine jepen edhe në FGJSSH. Folja **eliminohet** përdoret në kuptimin **zhduk**, ndaj mund të zëvendësohet fare mirë me këtë fjalë të

shqipes, p.sh.: Të **zhdukim** pasojat e tërmetit. *Penicilina zhduk pneumokokun brenda tri ditëve. Rreziku u zhduk* etj. Në fushë të sportit mendojmë se **eliminohj, eliminohem, eliminim** mund të zëvendësohen me fjalët **mënjanohem** dhe **mënjanim**, p.sh.: “*Flamurtari*” **mënjanoi** “*Lokomotivën*”. *Ndeshjet e kupës zhvillohen me sistem mënjanimi*.

erupsion, ~i m., **eruptiv**, ~e mb. Këto fjalë nuk janë në FGJSSH Në gjuhën tonë fjala **erupsion** ka hyrë nga frëngjishtja dhe është përdorur sidomos në gjeologji, në astronomi, në mjekësi etj. Mbiemri **eruptiv** ka kuptimin “që del me vrull, që shpërthen me furi”. Emri erupsion dhe mbiemri eruptiv në gjuhën shqipe zëvendësohen përkatësisht me **shpërthim** dhe **shpërthimor**, p.sh.: *Disa shpërthime në Diell kanë ndikime të menjëhershme në përhapjen e valëve elektromagnetike. Në vitin 1973 në afërsi të bregut të Islandës ndodhi një shpërthim vullkanik që formoi një ishull. Lufta për të mbyllur shpërthimin e fuqishëm në pusin 936 u kurorëzua me sukses të plotë. Shpërthim nëndetar. Vullkan në shpërthim etj., dhe Shkëmbinjtë shpërthimorë. Veprimtari shpërthimore etj.*

esenc/ë, ~a f., **esencial**, ~e mb. Të dyja këto fjalë janë me prejardhje nga italishtja. Për fjalën **esencë** “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” ka dhënë dy kuptime: “lëng i avullueshëm, i cili nxirret zakonisht nga disa bimë me erë të mirë... që përdoret kryesisht në parfumeri, në farmaceutikë e në industrinë ushqimore. P.sh.: **Esencë lulesh (bimësh); Esencë natyrore (artificiale)**. etj. Si fjalë me përdorim ndërkombëtar, në këtë kuptim ajo do të përdoret edhe në gjuhën shqipe. Në kuptimin e dytë, që është i figurshëm, “vetia më e rëndësishme e diçkaje, tipari më i rëndësishëm i diçkaje, ...**thelbi, qenësia**”, kjo fjalë duhet të zëvendësohet dhe është zëvendësuar tashmë me fjalën shqipe **thelb**. P.sh. në vend të: **Esenca e veprës (e përmbajtjes). Esenca e revolucionit. Esenca e çështjes** etj., përdoret fare mirë: **Thelbi i veprës (i përmbajtjes). Thelbi i revolucionit. Thelbi i çështjes** etj. Po kështu edhe shprehja librore **në esencë...** zëvendësohet me shprehjen shqipe **në thelb..., në të vërtetë...**, p.sh. **Në thelb (në të vërtetë), ai tha ato që duheshin thënë**. Mbiemri **esencial** është përdorur e po përdoret pa nevojë në mjaft togje të tilla, si: **Veçori esenciale. Dallim (kusht, tipar) esencial. Me rëndësi esenciale. Pjesë më esenciale** etj. Kjo fjalë ka nisur të zëvendësohet drejt me disa fjalë shqipe, si: **thelbësor, qenësor, i qenësishëm** etj. P.sh.: **Çështje thelbësore (qenësore). karakteristikë (veçori) thelbësore (qenësore). Tipar i qenësishëm (thelbësor)**.

eufoni, ~a f., eufonik, ~e mb. Terma të gjuhësisë me prejardhje nga greqishtja. “Fjalori i termave të letërsisë” (1965) këta terma i zëvendëson përkatësisht me **bukurzani, ~a** dhe **bukurzanor, ~e**. “Fjalori i termave të gjuhësisë” (1975) i jep përkatësisht me **bukurtingëllim, ~i** dhe **bukurtingëllues, ~e**. Edhe FGJSSH këta dy terma të huaj i jep pa shpjegim, duke i çuar përkatësisht te fjalët shqipe **bukurtingëllim, ~i** dhe

bukurtingëllues, ~e, të cilat këshillohen për t'u përdorur.

eveniment, ~i *m.* Fjalë me prejardhje nga gjuhët neolatine. Nuk jepet në FGJSSH. Në vend të kësaj fjale A. Xhuvani (në veprën “Për pastërtinë e gjuhës shqipe”) këshillon, ndër të tjera, fjalën shqipe **ngjarje**. Pra, në vend të fjalës *eveniment* duhet të përdoret fjala **ngjarje**, p.sh.: *Ngjarje e madhe historike* (në vend të: *Eveniment i madh historik*). *Ngjarje e jashtëzakonshme* (e rrallë, e rëndësishme) (në vend të: *Eveniment i jashtëzakonshëm...*) etj. Kjo fjalë përdoret zakonisht e ndjekur nga një përcaktor.

evident, ~e *mb.* Kjo fjalë librore, me prejardhje nga italishtja, nuk është dhënë në FGJSSH. Ajo mund të zëvendësohet, sipas rastit, me njërën nga këto fjalë ose shprehje të gjuhës sonë: **i qartë**, **i dukshëm**, **që duket sheshit**. Kështu, në vend të: *Lidhje evidente*. *Gjëra evidente* etj., mund të përdoren toget *lidhje të qarta*. *Gjëra të qarta (të dukshme, që duken sheshit)*. Po kështu duhet thënë: *Sukseset e letërsisë dhe të arteve tona janë të qarta (të dukshme)* (në vend të: *evidente*).

evituj kal., **evitohet** *pës.*, **evitim**, ~i *m.* Këto fjalë nuk jepen në FGJSSH. Folja **evituj** (dhe **evitohet**), me prejardhje nga gjuhët neolatine, mund të zëvendësohet me disa fjalë shqipe, sipas kuptimeve ose lidhjeve me fjalë të tjera, si p.sh.: **mënjanoj** (**mënjanohet**), **shmang** (**shmanget**). Kështu në vend të **evituj rrezikun** (*gabimin, të keqen* etj.), mund të përdoret sipas rastit **mënjanoj** (**shmang, i shmangem**) *rrezikun (gabimin, të keqen)*, p.sh.: *Popujt e botës duhet të bashkohen për të mënjanoj (për të shmangur) rrezikun e një lufte të re* (në vend të: *për të evituar*). *Të mënjanohen dhe të mos përsëriten më gabimet dhe të metat që u vunë re vitin e kaluar* (në vend të: *të evitohen*). Si rrjedhim, edhe emri **evitim** zëvendësohet me fjalët **mënjanim**, **shmangje**. Pra: **mënjanimi** *i të metave (i rreziqeve, i gabimeve)* ose **shmangia** *e të metave (e rreziqeve, e gabimeve)*. Edhe mbiemri i **paevitueshëm** zëvendësohet me **i pamënjanoeshëm**, **i pashmangshëm**, si p.sh.: *Dukuri (ngjarje) e pamënjanoeshme*. *Vdekja është e pamënjanoeshme*. *Revolucioni është i pashmangshëm*. etj.

fakt (në) Ky është një ndërtim i huaj. Në vend të kësaj shprehjeje duhet të përdoret shprehja **në të vërtetë**. Pra, në vend të: *Në fakt ai nuk dinte gjë që...* duhet të thuhet: *Në të vërtetë nuk dinte gjë që...*

fals, ~e *mb.* Kjo fjalë me burim të huaj, që “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” e çon te fjala “**i rremë**”, në shumë raste mund dhe duhet të zëvendësohet me këtë fjalë shqipe **i rremë**. P.sh. në vend të: *Monedhë false*. *Dëshmi false*. *Miqësi false*. *Lajm fals*. *Çelës fals* etj., mund të thuhet: *Monedhë (miqësi, dëshmi) e rreme*. *Lajm i rremë*. *Çelës i rremë* etj.

fanitet (më), **fanepset (më)** *vetv.* Fjalë e huaj me prejardhje nga greqishtja. E para është edhe në FGJSSH, por atje në vend të kësaj fjale

këshillohet të përdoren: **më përhihet, më shfaqet (më del) si hije**. Kështu, në vend të: *Iu faneps fytyra e nënës* duhet të thuhet: *Iu përhit fytyra e nënës*. *M'u faneps në gjumë — M'u shfaq në gjumë. Iu faneps në ëndërr - Iu shfaq në ëndërr* etj. Siç shihet, zëvendësimi i kësaj fjale të huaj nuk i sjell asnjë varfërim gjuhës sonë letrare, as nga ana kuptimore, as nga ana stilistike.

fenomen, ~i m. Është edhe në FGJSSH. Kjo fjalë me prejardhje nga greqishtja, prej kohësh ka nisur të zëvendësohet me fjalën **dukuri**, p.sh.: *Dukuri fizike (kimike, atmosferike, shoqërore, gjuhësore)*. *Dukuritë e natyrës* etj. (në vend të: *fenomene fizike, kimike, atmosferike...*). Në raste të veçanta, si në filozofi, në psikologji etj., termi **fenomen** përdoret gjerësisht si term ndërkombëtar. Në kuptimin e figurshëm (p.sh.: *Ai është një fenomen*) kjo fjalë mund të zëvendësohet me **i jashtëzakonshëm, i pashoq** (*Ai është i jashtëzakonshëm*). Në kuptimin “njeri shumë i shquar në fushën e artit, të kulturës etj.” (p.sh. *fenomen botëror*), kjo fjalë mbetet ende në përdorim.

filan pakuf., filan, ~i m., filan/e, ~ia f. Fjala **filan** ka hyrë në gjuhën shqipe nga turqishtja. Përdoret edhe si përemër i pakufishëm, në togje të tilla, si: *filan njeri, në filan vend* etj. edhe si emër në të dyja gjinitë, p.sh. *Ma tha filani. I erdhi filania*. Për të dyja rastet e përdorimit të kësaj fjale gjuha shqipe ka fjalët e saj **aksh, akëcili, akëcila**. p.sh.: *Aksh njeri. Në aksh vend. Më ka thënë akëcila. Në akëcilin fshat*.

filatur/ë ~a f. Kjo fjalë e huaj, e cila deri vonë është përdorur gjerësisht, ka hyrë në gjuhën shqipe nga gjuhët neolatine. Nuk është përfshirë në FGJSSH, sepse është zëvendësuar nga fjala **tjerrtore** (nga folja *tjerr* me prapashtesën **-tore**, njëlloj si thertore etj.) p.sh.: *Punon në tjerrtoren e Kombinatit të Tekstileve “Kosova”*. *Punonjësit e tjerrtores*.

firmë, ~a f. Fjalë që ka hyrë në shqipen nga gjuhët neolatine. Me temën e saj janë krijuar, brenda shqipes, edhe foljet **firmoj** a **firmos**. Në vend të këtyre fjalëve, prej kohësh në gjuhën shqipe përdoren fjalët **nëshkrim, nënshkruaj**. P.sh.: *Vuri nënshkrimin. Nënshkroi marrëveshjen*. Këto fjalë që i ka edhe FGJSSH, kanë zënë vend jo vetëm në stilin zyrtar, por edhe në stilin bisedor dhe në atë të letërsisë artistike. Si shembull le të përmendim disa vargje nga poema “Shqiponjat fluturojnë lart”, të I. Kadaresë: *Nënshkrimi i madh i Partisë që hedhur: “Komiteti Qendror i PK Shqiptare”... Duke nënshkruar dokumentin e parë*. Fjala **firmë** nuk është zëvendësuar kur përdoret në kuptimin “Ndërmarrje individuale a tregtare në vendet kapitaliste, e cila prodhon ose shet mallra me markën e vet”, p.sh.: *Firmë tregtare. Firmë e njohur*.

fokist, ~i m. Kjo fjalë e huaj, e cila haset ende në përdorim për të emërtuar punëtorin që ushqen e mban ndezur zjarrin në një lokomotivë, në një vapor etj. (kur punojnë me qymyrguri), ka hyrë në gjuhën shqipe nga italishtja. FGJSSH nuk e ka, sepse në vend të saj përdoret fjala shqipe

zjarrtar, e formuar nga emri **zjarr** me prapashtesën **-tar**, p.sh.: *Zjarrtari i lokomotivës. Kujdesi për shëndetin e zjarrtarëve.*

front, **~i m.**, **frontal**, **~e mb.**, **frontalisht ndajf.** Kjo çerdhe fjalësh të huaja ka në bazë temën e fjalës **front**, e cila ka hyrë në gjuhën shqipe nga gjuhët neolatine dhe përdoret kryesisht me kuptimin “pjesa e përparme ose e fillimit të diçkaje; ballë, kreu”. Në këtë kuptim ajo përdoret edhe në terminologjinë e minierave. Mund të zëvendësohet me fjalën shqipe **ballë**, p.sh.: *Balli i galerisë. Balli i tunelit.* Fjala **frontal**, **~e** përdoret sot në dy kuptime: në kuptimin “që bëhet në drejtim të ballit a ballë për ballë” ajo mund të zëvendësohet me fjalën shqipe **ballor**, **~e**, p.sh.: *Sulm ballor. Drejtim ballor. Mësymje ballore.*, kurse në kuptimin “që bëhet në ballë të gjerë, që i përfshin të gjitha njëkohësisht” ajo mund të zëvendësohet me **ballësor**, **~e**, p.sh.: *Përparim ballësor. Zgjidhje ballësore.* Në vend të fjalës **frontalisht** mund të përdoret togu **në mënyrë ballësore**.

frontespice, **~i m.** Lidhet me fjalën **front** dhe ka kuptimin “faqja e parë e një libri, ku shtypet titulli; figurë për zbukurim në faqen e parë të një libri ose në krye të fletës”. Për ta zëvendësuar atë, është krijuar fjala e re shqipe **ballinë**, e cila është dhënë edhe në FGJSSH dhe në fjalorë terminologjikë. P.sh.: *Ballina e librit. Faqosi ballinën. Vihet në ballinë.*

frutikultur/ë, **~a f.** Kjo fjalë e huaj nga fusha e bujqësisë është zëvendësuar fare mirë me fjalën **pemëtari**, p.sh.: *Sektori i pemëtarisë. Zhvillimi i pemëtarisë. Të ardhurat nga pemëtaria. Merren me pemëtari etj.* Edhe fjala **frutikultur**, **~i**, që emërton punonjësin që merret me pemëtari, zëvendësohet me fjalën shqipe **pemëtar**, p.sh.: *Janë të përmendur si pemëtarë të zotë. Këshilla për pemëtarët.* Të dyja fjalët, **pemëtari** dhe **pemëtar** po përdoren tashmë gjerësisht dhe janë pasqyruar edhe në FGJSSH, ndërsa fjalën **frutikulturë** e çon te fjala **pemëtari**.

gjiton, **~i m.**, **sh. ~ë, ~ët**; **gjiton/e**, **~ia f.**, **sh. ~e, ~et.** *Shih: komshi, ~u m., komshi/e, ~a f.*

goniomet/ër, **~ri m.** Kjo fjalë e huaj që shënon një vegël të posaçme për të matur këndet, është shqipëruar me fjalën shqipe **këndmatës**, p.sh.: *Këndmatës i thjeshtë.*

granuloj kal., **granulohet vetv.**, **granulim**, **~i m.**, **granular** (i, e) **mb.** Fjala **granuloj**, me temë neolatine, mbulohet në të gjitha kuptimet e saj nga fjala shqipe **kokrrizoj**, p.sh.: *Kokrrizon lëndën plastike. Kokrrizon pluhurin.* Edhe fjalët e prejardhura **granulohet**, **granulim**, **i granular** zëvendësohen me fjalët shqipe: **kokrrizohet**, **kokrrizim** dhe **i kokrrizuar**, p.sh.: *Është lëndë që kokrrizohet. Makinë kokrrizimi, Superfosfat i kokrrizuar. Pluhur i kokrrizuar.* Nganjëherë përdoret edhe fjala e huazuar **granulë** që

zëvendësohet me shqipen **kokrrizë**. Po kështu mbulohet nga fjala shqipe **kokrrizor**, **~e** mbiemri **granular**, **~e**, p.sh.: *Ndërtim kokrrizor, Pleh kokrrizor. Borë kokrrizore.*

gusto, **~ja** f., sh. **~, ot.** FGJSSH nuk e ka këtë fjalë të huazuar nga italishtja, sepse në vend të saj në gjuhën shqipe përdoret prej kohësh fjala **shije**, p.sh.: *Me shije të hollë. Njeri me shije. Ua dinë shijet. Ka shije. Vishet me shije. I kënaq shijet.*

herbarium, **~i** m. Fjalë e huaj e burimit latin që përdoret me kuptimin “koleksion bimësh të thara për qëllime studimi”. Mund të zëvendësohet me fjalën shqipe **bimëtore**, të cilën e këshillon edhe FGJSSH. Kështu po përdoret edhe në tekstet mësimore, p.sh.: *Bimëtorja e shkollës. Paraqitën një bimëtore. E vendosi në bimëtore.*

hezitoh jokal., **hezitim**, **~i** m. Fjalë me temë të huazuar nga gjuhët neolatine. Në FGJSSI4 nuk janë dhënë, sepse në vend të tyre përdoren prej kohësh fjalët shqipe **ngurroj**, **ngurrim**, p.sh.: *Ngurroj ta marr. E bën pa ngurruar. Një çast ngurrimi. E bëri pa ngurrim. Pati njëfarë ngurrimi.*

identik, **~e** mb. Fjalë me prejardhje nga gjuhët neolatine. Përdoret kryesisht në ligjërimin libror. FGJSSH e jep me “i njëjtë me një tjetër; që është po ai”. Në vend të këtij huazimi mund të përdoret formimi shqip **i njëjtë**, i cili ia mbulon kuptimin, ose sinonimi **i njëjlojtë**, p.sh.: *Qenie (sende) të njëjta (të njëjlojta). Mendime (pikëpamje, synime, qëllime) të njëjta (të njëjlojta). Kushte (rrethana) të njëjta (të njëjlojta). Janë të njëjtë (të njëjlojtë).*

igrasi, **~a** f. Fjalë e huaj, me përdorim krahinor, që ka hyrë në gjuhën shqipe nga greqishtja. Në vend të saj shqipja ka **lagështirë**, **lagështi**, formuar nga tema e mbiemrit **i lagësht**, p.sh.: *Ka lagështirë të madhe. Ka marrë lagështirë. U dëmtua nga lagështira. Lagështia e ajrit.*

imediati, **~e** mb. Ka hyrë në gjuhën shqipe nga gjuhët neolatine dhe përdoret ende pa nevojë në ligjërimin libror. Në vend të saj ka kohë që po përdoren mbiemrat **i menjëhershëm** dhe **i pandërmjetëm**, p.sh. *Masa të menjëhershme. Duhet zgjidhur sa më parë nevojat e menjëhershme (e pandërmjetme). Detyra të menjëhershme.*

imperativ, **~e** mb. Fjalë e huaj me prejardhje nga gjuhët neolatine. Në vend të saj përdoren fjalët shqipe **urdhërues** dhe **i domosdoshëm**. Pikërisht duke u nisur nga kjo, FGJSSH nuk e ka përfshirë fjalën e huaj **imperativ**. Ja një varg shembujsh ku përdoret fjala shqipe në vend të fjalës së huaj **imperativ**: *Detyrë (kërkesë) e domosdoshme. Në mënyrë të domosdoshme (ose urdhëruese). Është detyrë e domosdoshme të ruajmë gjakftohtësinë dhe vigjilencën revolucionare. Çdo ditë që kalon e bën gjithnjë më të ngutshme*

dhe të domosdoshme. I bindet zërit **urdhërues** të ndërgjegjes.

implikoj kal., **implikohem** vetv. Këto fjalë me temë të huazuar nga gjuhët neolatine nuk janë përfshirë në FGJSSH. Në vend të tyre prej kohësh përdoren fjalët **ngatërroj** a **përziej**, **ngatërrohem** a **përzihem**, p.sh.: *Dëshën ta ngatërroin (ta përzienin) edhe atë në këtë punë. Nuk është ngatërruar (nuk është përzier) në atë çështje.* Në stilin bisedor në vend të fjalës së huaj **implikohem**, mund të përdoret edhe shprehja frazeologjike **ka gisht**, p.sh. *Në këtë çështje ka gisht edhe ai.*

impozant, **~e** mb. Fjalë e huaj që ka hyrë në gjuhën shqipe nga frëngjishtja dhe që është përdorur kryesisht si fjalë librore. Vendin e saj tashti e kanë zënë fjalët **hijerëndë** dhe **madhështor**, **~e**, p.sh.: *Shtatore (përmendore) hijerëndë. Përpara na del tabloja madhështore e Shqipërisë demokratike. Atij i pëlqente të fliste me një ton madhështor.* Si shihet edhe nga këta shembuj, fjala **impozant** është krejt e panevojshme në gjuhën shqipe, prandaj, me të drejtë, ajo nuk është pasqyruar në FGJSSH.

inauguroj kal., **inaugurohet** pës., **inaugurim**, **~i** m. Kjo çerdhe fjalësh, me temë të huazuar nga gjuhët neolatine, gjendet edhe në FGJSSH. Në vend të tyre tani përdoren gjerësisht fjalët shqipe përkatëse: **përuroj**, **përurohet** dhe **përrurim**, p.sh.: *Përruruan uzinën (fabrikën, teatrin e ri). U përruua shkolla (hekurudha, rruga) e re. Përrurimi i uzinës. U bë përrurimi. Në ditën e përrurimit.*

indeks, **~i** m. Në vend të kësaj fjale të huaj librore, që ka hyrë në gjuhën shqipe nga frëngjishtja, ka kohë që po përdoret fjala shqipe **tregues**. Kjo përdoret jo vetëm në letërsinë politiko-shoqërore, por edhe në letërsinë shkencore e teknike, p.sh.: *Treguesi i përgjithshëm i çmimeve. Treguesi lindjeve (i vdekjeve). Treguesi alfabetik (kronologjik, gjeografik, bibliografik). Treguesi i dendurisë. Të dhënat e treguesit. Treguesi ka disa nënndarje. Një tregues i mirëqenies së masave punonjëse.*

indinjatë, **~a** f., **indinjoj** kal., **indinjohem** vetv., **indinjuar** (i,e) mb. Fjala **indinjatë**, që përdoret në ligjërimin libror, ka hyrë në gjuhën tonë nga gjuhët neolatine, me përshtatje prapashtesore brenda shqipes. Ajo po zëvendësohet nga fjala shqipe **zemëratë**, ndonjëherë edhe nga fjala **zemërim**, p.sh.: *Shpërthimi i zemëratës popullore. E mësoi me zemëratë të thellë. Ata e shprehën zemëratën e tyre me protesta. U ngrit një valë e re zemërate dhe urrejtjeje. E kuptoj zemëratën tuaj (ose edhe: zemërimin).* Edhe për fjalët e tjera që janë formuar brenda shqipes nga tema e kësaj fjale të huazuar, si: **indinjoj**, **indinjohem**. i **indinjuar**, kemi fjalët shqipe **zemëroj**, **zemërohem**, i **zemëruar** ose edhe shprehjet **mbush me zemërim e me urrejtje**, **mbushem me zemërim e me urrejtje**, të cilat mbulojnë plotësisht kuptimin e fjalëve të huaja të mësipërme.

indipendenc/ë, ~a f., independent, ~e mb. FGJSSH nuk i ka këto fjalë të huazuara nga italishtja, sepse në vend të tyre përdoren prej kobësh fjalët shqipe **pavarësi** dhe **i pavarur**: *Pavarësia kombëtare (politike, ekonomike). Mbrojtja e pavarësisë. Shpallja e pavarësisë. Dita e Pavarësisë. Lufta për pavarësi. Shtet i pavarur. Është i pavarur.*

infektiv, ~e mb. Fjalë e huaj që përdoret në terminologjinë e mjekësisë me kuptimin “që ka aftësinë të kalojë nga një i sëmurë te një i shëndoshë (për sëmundjet)”. Ka filluar të zëvendësohet me fjalën shqipe **ngjitës, ~e**, p.sh.: *Sëmundje ngjitëse. Nuk është ngjitëse.*

influenc/ë, ~a f., influencoj kal., influencohem vetv., influencuar (i, e) mb. Fjala e huaj **influcencë**, që ka hyrë në gjuhën tonë nga gjuhët neolatine, tashmë është zëvendësuar plotësisht nga fjala **ndikim**. Ja disa shembuj të përdorimit të fjalës **ndikim** në vend të **influcencë**: *Ka ndikim të madh. Nën ndikimin e të tjerëve. Ndikimet e huaja. Superfuqitë mundohen të ruajnë sferat e tyre të ndikimit.* Edhe foljet **influcencoj, influencohem**, që janë formuar nga tema e kësaj fjale të huazuar, tashmë janë zëvendësuar plotësisht në gjuhën shqipe me **ndikoj, ndikohem**. P.sh.: *Ka ndikuar për mirë (për keq). Kushtet e punës e të jetës ndikojnë në botëkuptimin e njerëzve. Ai ndikohet shumë nga fjalët e të tjerëve.* Fjalët **influcencë, influencoj, influencohem** FGJSSH, me të drejtë, nuk i shpjegon, por i çon te fjalët shqipe **ndikoj e ndikohem**.

informoj kal., informohem pës., informim, ~i m., informat/ë, ~a f. Kjo çerdhe fjalësh të huaja ka hyrë në gjuhën shqipe nga gjuhët neolatine. Jepet edhe në FGJSSH, Përdorimi i tyre mund të kufizohet në një shkallë të madhe duke i zëvendësuar, sipas rastit, me fjalë e shprehje shqipe: **informoj, informohem** me **lajmoj e lajmëroj, lajmohem e lajmërohem, njoftoj e njoftohem, vë në dijeni, bëj të ditur; informim e informatë** me **lajm, lajmërim, njoftim, vënie në dijeni**. P.sh.: *Sot na lajmëruan (na njoftuan) se... (në vend të: na informuan). Njoftoj drejtorinë për kryerjen e detyrave (në vend të: informoj). Njoftohemi se mbjellja e grurit ka përfunduar (në vend të: informohemi se...); Na vini në dijeni (ose na njoftoni, na lajmëroni) për gjithçka do të vëreni (në vend të: na informoni). Njoftimi (vënia në dijeni) i kolektivit (në vend të: informimi). Njoftimi ishte i saktë (në vend të: informata). Njoftime të rëndësishme (në vend të: informime) etj.*

iniciativ/ë, ~a f., iniciator, ~i m. Këto fjalë kanë hyrë në gjuhën shqipe nga gjuhët neolatine. Për fjalën **iniciativë** FGJSSH në kuptimin e parë (“Punë që e merr përsipër i pari dhe me vullnetin e me dëshirën e vet një punonjës a një kolektiv për të bërë ose për të organizuar diçka, zakonisht të re e që kërkon përpjekje”) këshillon të përdoret fjala **nismë**, e cila ka hyrë në përdorim prej kohësh dhe e mbulon plotësisht kuptimin e fjalës së huaj, p.sh.: *Nismë krijuese. Nismë revolucionare. Nxit nismën. Thelloj (përhap,*

përqafoj) një **nismë**. Marr **nismën** “filloj të veproj unë i pari”. Shpërthyen **nisma** të reja. E **përkrahën nismën e punëtorëve**. Në kuptimin e dytë (“Aftësi për të çarë i pari e në mënyrë të pavarur në punë a në jetë, për të filluar një punë e për të vetëvepruar, për t’i dhënë shtysën e parë diçkaje”) kjo fjalë e huazuar mund të zëvendësohet me fjalën shqipe **vetëveprim**, të cilën FGJSSH e jep si sinonim të saj, p.sh.: *Njeri me vetëveprim*. *Shpirti i vetëveprimit*. Për fjalën **iniciator** FGJSSH jep sinonimet shqipe **nismëtar** dhe **nismës**, që e zëvendësojnë plotësisht fjalën e huaj, p.sh.: *Nismëtari kryesor*. *Nismëtar i guximshëm*. *Është nismëtar i kësaj pune*. *Nismëtar i një metode të re*.

insistoj *jokal.*, **insistohet** *vetv.*, **insistim**, **~i m.**, **insistues**, **e mb**. Këto fjalë nuk i ka FGJSSH. Janë huazime me temë nga gjuhët neolatine. Fjala **insistoj** ka kuptimin “ngul këmbë për diçka, kërkoj me forcë të më plotësohet një dëshirë etj.; i mbahem me ngulm mendimit tim”, kuptime këto që i mbulon plotësisht togu **ngul këmbë**. Krahas togut ngul këmbë kanë filluar të përdoren edhe fjalët **këmbëngul** dhe **ngulmoj**, te cilat i këshillon edhe A. Xhuvani në veprën e tij “Për pastërtinë e gjuhës shqipe” dhe i pasqyron edhe FGJSSH. Pra duhet thënë: *Ngulte këmbë (këmbëngulte, ngulmonte) për zbatimin e detyrave*. *Ngul këmbë me të drejtë*. *Ngulte këmbë në mendimin e vet*. Edhe fjalët e prejardhura **insistim** dhe **insistues** zëvendësohen me fjalët shqipe **këmbëngulje** a **ngulmim**, **këmbëngulës** a **ngulmues**, p.sh.: *Lufton me këmbëngulje (me ngulmim)*. *Studion me këmbëngulje (me ngulmim)*. *Qëndrim këmbëngulës (ngulmues)*. *Përpjekje këmbëngulëse (ngulmuese)*.

inspiroj *kal.*, **inspirohem** *pës., vetv.*, **inspirim**, **~i m.**, **inspirues**, **~e mb**. Këto fjalë me temë nga gjuhët neolatine FGJSSH nuk i ka. Folja **inspiroj** përdoret me kuptimin “bëj që të lindë në ndërgjegjen e dikujt një mendim, një ndjenjë etj” dhe është zëvendësuar fare mirë me foljen **frymëzoj**. Ja disa shembuj: *Idetë e Partisë frymëzojnë gjithë popullin*. *Janë frymëzuar nga shembulli i klasës punëtore*. Edhe fjalët e prejardhura **inspirim**, **inspirues** janë zëvendësuar përkatësisht me **frymëzim**, **frymëzues**, p.sh.: *Frymëzimi i poetit*. *Burim frymëzimi*. *Shembull frymëzues*.

internacional, **~e f**. Në vend të këtij termi po përdoret fjala shqipe **ndërkombëtar/ë**, **~e** E ka edhe FGJSSH. Është një emëzim, sipas rregullave të shqipes, i mbiemrit të gjinisë femërore **ndërkombëtar/e**, **~ja**, p.sh. *Ndërkombëtarja komuniste*. *Ndërkombëtarja socialiste*. *Udhëheqësit e ndërkombëtares*. Termi **internacional/e**, **~ja** në kuptimin e këngës luftarake të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, të himnit ndërkombëtar të proletariatit, do të vazhdojë të përdoret p.sh.: *Nën tingujt e Internacionales*. *Buçet Internacionalja*.

intoksikohet *vetv.*, **intoksikacion**, **~i m.**, **intoksikim**, **~i m**. Fjalë me temë të huazuar nga gjuhët neolatine. Hasen sidomos në shkrime mjekësore,

veterinare dhe bujqësore. FGJSSH nuk i jep këto fjalë. Në vend të këtyre huazimeve të panevojshme duhet të përdoren fjalët shqipe **helmohet**, **helmim**, p.sh.: *U helmua nga ushqimi. Helmim i rëndë (i lehtë, i plotë, i pjesshëm). Helmin nga ushqimi.* Në raste të veçanta mund të përdoret edhe varianti **helmatis**, **helmatisje**.

introduksion, **~i** *m.* Kjo fjalë, e huazuar nga gjuhët neolatine, pothuajse nuk përdoret më në gjuhën shqipe. Ajo është zëvendësuar me fjalën shqipe **hyrje**. Ja disa shembuj: *Hyrja e veprës. Është e pajisur me një hyrje. Hyrje e gjatë (e shkurtër).*

kaldaj/ë, **~a** *f.* Fjalë e huaj që ka hyrë në gjuhën shqipe nga italishtja. E ka edhe FGJSSH, i cili jep edhe sinonimin e saj shqip **ngrohtore**, që e zëvendëson mirë fjalën e huaj. Kështu mund të thuhet: *Ngrohtore elektrike. Ngrohtore me dy furra. Punon në ngrohtore.* etj. Edhe fjala **kaldajist**, e huazuar po nga italishtja, zëvendësohet me fjalën shqipe **ngrohtar**, **~i**, p.sh.: *Brigada e ngrohtarëve. Është ngrohtar i dalluar.*

kalkuloj *kal.*, **kalkulim**, **~i** *m.* Termi **kalkuloj**, me temë të huazuar nga gjuhët neolatine, përdoret me kuptimin “bëj veprime me numra për të nxjerrë një përfundim ose për të gjetur atë që kërkohet”. Në këtë kuptim, në vend të këtij termi, përdoret fjala shqipe **njehsoj**, p.sh.: *Njehsoj sipërfaqen (vëllimin) e një trangu. Njehsoj shpejtësinë (kohën).* Edhe emri **kalkulim** zëvendësohet me fjalën **njehsim**, që lidhet nga pikëpamja fjalëformuese me foljen njehsoj, p.sh.: *Njehsimi i sipërfaqes (i gjatësisë, i lartësisë) së një trupi.* Në ligjërimin libror kalkuloj përdoret edhe me kuptimin e foljes **llogarit**: *Llogarit me përpikëri. E llogarit me laps në dorë.* Prandaj, sipas rastit, në vend të **kalkuloj** të përdoret fjala **llogarit**, ndërsa në vend të emrit **kalkulim** fjala e prejardhur shqipe **llogaritje**: *Llogaritje aritmetike. Llogaritja e një këndi.* Fjala e huazuar **kalkulatriç/e**, **~ja**, që përdoret si term në fushën e matematikës, mbulohet plotësisht me togjet e shqipes **makinë llogaritëse**, **makinë njehsuese**, sipas tipit të emërtimeve të pathjeshta **makinë shirëse**, **makinë larëse** etj.

kallaballëk, **~u** *m.* Fjalë e huaj që ka hyrë në gjuhën shqipe nga turqishtja dhe përdoret kryesisht në ligjërimin bisedor. E ka edhe FGJSSH, si fjalë të ligjërimin bisedor, me kuptimin “grup i madh njerëzish, shumicë njerëzish; gjindje e madhe; turmë”. Në vend të saj mund të përdoret fjala **turmë**, por, sipas rastit, edhe togfjalëshat **gjindje e madhe**, **shumë njerëz** (ose **shumë**), p.sh.: *U fut në turmë. Gjindje (turmë) e madhe. Kishte shumë njerëz. Jemi (bëhemi) shumë.* Megjithatë në biseda, në letërsinë artistike, në frazeologji (Mblidhe kallaballëkun) mund të përdoret me vlera stilistike.

kalorimet/ër, **~ri** *m.* Ky term ndërkombëtar i fizikës e i kimisë me kuptimin “mjet për të matur sasinë e nxehtësisë që thithin ose lëshojnë

trupat”, zëvendësohet me fjalën shqipe **nxehhtësimatës**, të cilën e ka edhe FGJSSH.

karshi *ndajf.* dhe *paraf.* Është fjalë e ligjërimit bisedor, e huazuar nga turqishtja. Përdoret si ndajfolje dhe si parafjalë. FGJSSH e ka këtë fjalë, por nuk e shpjegon dhe të çon te fjalët shqipe, përkatësisht: **përballë**, **ballë për ballë**, **përkundrejt**: *I rri përballë (ballë për ballë, përkundrejt). Në shtëpinë përballë (përkundrejt). Mali që ndodhet përballë (ballë për ballë, përkundrejt)*, ndërsa për përdorimet si parafjalë këshillohen, sipas rastit, fjalët dhe shprehjet **përballë**, **kundrejt**, **përpara**, **ndaj**; **në krahasim me**, p.sh.: **Përballë (kundrejt, përpara) shtëpisë. Detyrat ndaj Atdheut (Partisë, popullit)**. Pra, siç shihet, shqipja ka vetë disa mjete e mënyra për ta zëvendësuar fjalën e huaj.

kaskad/ë, **~a** *f.* Edhe kjo fjalë, si sinonim i fjalës **katarakt**, është përdorur pa nevojë për fjalën **ujëvarë**.

katarakt, **~i** *m.* Kjo temë nga gjuhët neolatine, që ka kuptimin “rrjedhë uji që bie me rrëmbim nga një lartësi e madhe dhe e thiktë”, është përdorur pa nevojë për fjalën shqipe **ujëvarë**, p.sh.: **Ujëvarat e Drinit. Bie si ujëvarë**. Fjala shqipe **ujëvarë** përdoret edhe me kuptim të figurshëm, p.sh.: **Ujëvarë drite**.

koagulon *kal. e jokal.*, **koagulohet** *vetv.*, **koagulum**, **~i** *m.*, **koagular** (*i, e*) *mb.* Kjo çerdhe fjalësh me temë nga gjuhët neolatine përdoret kryesisht në mjekësi. Në vend të **koagulon**, **koagulohet** në gjuhën shqipe përdoren fjalët **mpiks**, **mpikset**, p.sh.: **E mpiks gjakun. Mpikset shpejt**. Në vend të **koagulum** përdoret emri **mpiksje**, ndërsa mbiemri **i koagular** zëvendësohet me **i mpiksor**. Prandaj thuhet: **Mpiksja e gjakut. Gjak i mpiksor**.

koincidon *jokal.* Kjo fjalë me temë të huaj nuk jepet në FGJSSH. Në gjuhën tonë fjala **koincidon** është përdorur me kuptimet: 1) “Ka gjëra të njëjta a të përbashkëta me diçka tjetër”; 2) “Ndodh në të njëjtën kohë me diçka tjetër, bie në po atë kohë”. Në këto kuptime ajo zëvendësohet plotësisht me fjalët shqipe **përkon**, **përputhet**, **pajtohet**, p.sh.: **Thëniet e tyre përkonin. Përvjetori përkonte me një ngjarje tjetër të rëndësishme politike. Ardhja e tij përkoj me ditëlindjen tënde**.

kolektiv, **~e** *mb.*, **kolektivisht** *ndajf.* Fjalë me temë nga gjuhët neolatine. Përdoren shumë në ligjërimit libror. I ka edhe FGJSSH. Mbiemri **kolektiv**, **~e** zëvendësohet me fjalën shqipe **i (e) përbashkët**, p.sh.: **Punë e përbashkët. Përgjegjësi e përbashkët. Banesë e përbashkët. Kullotë e përbashkët**. Si term gjuhësor është zëvendësuar prej kohësh me fjalën shqipe **përmbledhës**, p.sh.: **Emër përmbledhës. Me kuptim përmbledhës.**, por vijon të përdoret si term në ekonomi, p.sh.: **Pronë kolektive. Normë kolektive**. Ndajfolja kolektivisht po

zëvendësohet me fjalët shqipe **së bashku, bashkërisht** (kur nuk ka kuptimin “si kolektiv, me kolektivin”), p.sh. *Punojmë së bashku (bashkërisht)*.

komplikoj kal., komplikim, ~i m., komplikuar (i, e) *mb.* Kjo çerdhe fjalësh, që zë fill nga një temë e burimit neolatin, nuk është përfshirë në FGJSSH, sepse në vend të këtyre fjalëve të huaja të ligjërimit bisedor, përdoren fjalët shqipe **ndërlikoj, ndërlikim, i ndërlikuar; koklavit, koklavitje. i koklavitur;** në disa raste mund të përdoren edhe fjalët **ngatërroj. ngatërrim, i ngatërruar.** Ja një varg thëniesh që dëshmojnë përdorimin e këtyre fjalëve në vend të fjalëve **komplikoj, komplikim, i komplikuar.** *Ndërlikoj një ushtrim. E ndërlikuan çështjen. Ndërlikimi i gjendjes. Figurë e ndërlikuar. Detyrë e koklavitur. Punë e koklavitur (e ngatërruar).*

komshi, ~u m., sh. ~nj, ~njt; komshi/e, ~a f., sh. ~e, ~et. Fjalë e huazuar nga turqishtja. FGJSSH e ka këtë fjalë, por nuk e shpjegon dhe e çon te fjalët shqipe **fqinj, ~i m. dhe fqinj/ë, ~a f.,** p.sh.: *Fqinji im. Shkoj te fqinjët. Fqinjë e mire. Është fqinja ime.* Në përdorim mbiemëror fjala e huaj duhet zëvendësuar me shqipen **fqinj, ~e,** p.sh.: *Fshati fqinj.* Edhe fjala tjetër e huazuar **gjiton,** duhet zëvendësuar, si emër dhe si mbiemër, me fjalët shqipe, përkatësisht: **fqinj, ~i m., fqinj/ë, ~a f. dhe fqinj, ~e mb.**

koncentroj kal., koncentrohem vetv., koncentrim, ~i m. koncentruar (i, e) *mb.* Fjala **koncentroj,** me temë nga gjuhët neolatine, është zëvendësuar me fjalën **përqendroj,** p.sh.: *Përqendroi forcat. Përqendruan zjarrin. Përqendruan pushtetin (fuqinë) në duart e veta.* Edhe **koncentrahet** është zëvendësuar me **përqendrohet,** ndërsa mbiemri **i koncentruar** me **i përqendruar;** të gjitha këto fjalë të prejardhura lidhen me temën e foljes **përqendroj.** Prandaj duhet të thuhet: *Nuk përqendrohet dot. Përqendrimi i prodhimit. Me vështrim të përqendruar.*

kondicionoj kal., kondicionohet vetv., kondicionim, ~i m., kondicionuar (i, e) *mb.* Këto fjalë, me temë të huazuar nga gjuhët neolatine, nuk jepen në FGJSSH, sepse në vend të tyre prej kohësh po përdoren fjalët e ndërtuara me temën **kushtëztoj, kushtëzohet, kushtëzim, i kushtëzuar,** p.sh.: *Plani i prodhimit kushtëzon planin e shpërndarjes. Kushtëzohet nga gjendja politike. Kushtëzimi i veprimeve. Dukuri e kushtëzuar. Refleks i kushtëzuar / psikol. Ajër i kushtëzuar.*

kondit/ë, ~a f. Në vend të fjalës **konditë** FGJSSH këshillon që të përdoret fjala **kusht** p.sh.: *Kusht i domosdoshëm (kryesor). Kushtet ekonomike (shoqërore). Kushtet e jetesës. Kushtet e armëpushimit. Kapitullim pa kushte. Dënim me kusht / drejt.*

kondit/ë, ~a f., sh. ~a, ~at. Këtë fjalë me temë të huazuar nga gjuhët neolatine FGJSSH e ka, por nuk e shpjegon; në vend të saj këshillon fjalën

kusht, që përdoret prej kohësh dhe e zëvendëson në të gjitha kuptimet: *Kusht i domosdoshëm. Kushte ekonomike. Kushti i parë (i dytë, i tretë...)* **Kusht kryesor**. I ka të gjitha **kushtet**. *Punonte në kushte të vështira. Me kusht që...*

konfundoj kal., **konfundohet** vetv., **konfondim**, ~i m., **konfunduar** (i, e) mb. Folja **konfundoj**, me temë nga gjuhët neolatine, ka kuptimin “përziej bashkë pa rregull e pa kriter; ngatërroj në mendje; marr një gjë për një gjë tjetër”. Nuk është e përfshirë në FGJSSH, sepse me këtë kuptim përdoren fjalët shqipe **ngatërroj**, **përziej**. Ja disa shembuj: *I ngatërruan emrat. Më ngatërroi me një shokun e vet. Ngatërroi ngjyrat. U ngatërruan nocionet*. Edhe në vend të fjalëve të prejardhura **konfondim**, **i konfunduar** përdoren fjalët shqipe **ngatërrim**, **i ngatërruar**. P.sh.: *Ngatërrimi i dy çështjeve të ndryshme. Ngatërrimi i emrave (i datave)*.

konfrontoj kal., **konfrontohem** vetv., **konfrontim**, ~i m. Kjo çerdhe fjalësh, që zë fill nga një temë e burimit neolatin, nuk është përfshirë në FGJSSH, sepse në vend të tyre në shqipen përdoren fjalët **ballafaqoj**, **ballafaqohem**, **ballafaqim**, p.sh.: *Ballafaqoj mendimet (pikëpamjet, përvojën, metodën e punës) me një tjetër. U ballafaquan para kolektivit. Ballafaqimi i së resë me të vjetrën. Metoda e ballafaqimit. Ballafaqimi është një nga format më të frytshme të kontrollit punëtor*. Sipas rastit, fjalët **konfrontoj**, **konfrontohem** e **konfrontim** zëvendësohen edhe me fjalët **përqas**, **përqasem** e **përqasje**, p.sh.: *Përqas dy përkthime. Përqasja e dy gjuhëve*.

konkluzion, ~i m., **konkludoj** kal. Fjala **konkluzion** ka hyrë në gjuhën shqipe nga gjuhët neolatine. E ka edhe FGJSSH me kuptimin kryesor “përfundim, mendim përgjithësues që nxirret pasi shqyrtohet e studiohet një çështje a diçka tjetër, duke u mbështetur në të dhëna të ndryshme”; prandaj edhe këshillohet që në çdo rast, në vend të **konkluzion** të përdorim fjalën shqipe **përfundim**, p.sh.: *Përfundim logjik (i drejt). Përfundimi që del nga përvoja. Nxjerr përfundimet*. E një rrënjë me **konkluzion** është edhe folja **konkludoj** — **përfundoj**, “arrij në një mendim përgjithësues pasi shqyrtohet a studiohet një çështje, duke u mbështetur në të dhëna të ndryshme”. Kuptimi i saj mbulohet me foljen **përfundoj**, ose, sipas rastit, me togfjalësha të ndërtuar me foljet **nxjerr**, **arrij** etj. **përfundim**, p.sh.: *Tani po përfundoj. Duke përfunduar. Përfunduan një marrëveshje. Ata nxorën përfundimin se... Arritën në përfundim se...* Në terminologjinë sportive, **konkludoj** mbulohet edhe me foljen **shënoj**, p.sh.: *Nuk arrin të shënojë*.

konsiston jokal. Kjo folje e leksikut libror, me temë të huazuar nga gjuhët neolatine, nuk përfshihet në FGJSSH, sepse në vend të saj në shqipen e sotme përdoret rregullisht fjala **qëndron**, p.sh.: *Ku qëndron shkaku i këtij ndryshimi? Këtu qëndron e vërteta*. (Fjala **konsistim** ka këto kuptime: fortësi, dendësi, lidhmëria më e dobët apo më e fortë e përbërësve, qëndrueshmëri;

fig. përhershmeri, palëkundshmeri. Folja **konsiston** ka këto kuptime: të jesh i qëndrueshëm, i ngulmët, që bëhet pa iu ndarë dhe me të gjitha forcat, që bëhet me këmbëngulje MD).

konsultor/e, ~ja *f. sh. ~e, ~et.* Fjalë me temë të huazuar nga gjuhët neolatine. Gjendet edhe në FGJSSH. Fjala shqipe **këshillimore**, që e zëvendëson në të gjitha kuptimet, ka filluar të përdoret gjerësisht, p.sh.: **Këshillimorja e grave (e femijëve).** **Këshillimorja e lagjes (e fshatit).** Çoj femijën në **këshillimore**.

kontemporan, ~e *mb.* Fjalë e huaj që ka hyrë në gjuhën e shkrimit nga gjuhët neolatine. Nuk e ka FGJSSH. Kjo fjalë është zëvendësuar me fjalën shqipe **bashkëkohor, ~e**, pra: *Qytetërimi bashkëkohor. Shoqëria (muzika, pedagogjia) bashkëkohore. Autorët (shkrimtarët) bashkëkohorë.*

koordinoj kal, koordinim, ~i m., koordinues, ~e mb., koordinuar (i, e) *mb.* Këto fjalë kanë temë të huazuar nga gjuhët neolatine. Gjithë këtë çerdhe fjalësh FGJSSTI nuk e jep. Kuptimin e foljes **koordinoj** e mbulon fjala shqipe **bashkërendoj**, p.sh. **Bashkërendoj** detyrat (forcat, përpjekjet, veprimet...). Edhe fjalët e prejardhura **koordinim, koordinues** dhe **i koordinuar** janë zëvendësuar me fjalët e shqipes **bashkërendim, bashkërendues, i bashkërenduar**, p.sh: **Bashkërendim** i veprimtarisë (i pikëpamjeve, i qëndrimeve). **Organet bashkërenduese. Veprime (lëvizje) të bashkërenduara.**

korparmat/ë, ~a *f., sh. ~a, ~at.* Fjalë e terminologjisë ushtarake e huazuar nga italishtja. FGJSSH këtë fjalë e ka lënë vetëm në një kuptim, si *hist.*, pasi kështu emërtohej njësia më e madhe e ushtrisë sonë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare (“Përpara **korparmatë**, / armik mos lër mbi dhe, / me gjakun e heronjve, / ndërto Shqipërinë Re!”). Në kuptimin “Njësi e madhe ushtarake që përbëhet nga disa divizione dhe nga trupa speciale” është zëvendësuar me **truparmatë**, siç e jep edhe FGJSSH. P.sh. *Shtabi i truparmatës.*

korrektur/ë, ~a *f.* Kjo fjalë e huaj përdoret kryesisht si term në fushën e shtypshkronjës. FGJSSH kuptimin e dytë të saj “ndryshimi që i bëhet diçkaje për ta përmirësuar; shenja që tregon gabimet në një faqe të shkruar me dorë a me shtyp”, nuk e shpjegon, por e çon te fjala shqipe **ndreqje** që e zëvendëson plotësisht, p.sh. **Bëj ndreqjet e duhura.** Termi korrekturë vijon të përdoret në kuptimin e parë “fletë e shtypur a fashikull, që përmban një tekst dhe shërben si kopje për të ndrequr gabimet e shtypit; bocë.

korrent, ~i *m.* Fjalë me burim nga gjuhët neolatine. Është zëvendësuar me fjalën shqipe **rrymë**, të cilën e këshillon edhe FGJSSH. Ja disa shembuj: **Rrymë** elektrike. **Rrymë** e vazhdueshme. **Rrymë** trefazëshe (shumëfazëshe). **Burim rryme. Ushqen me rrymë. I ndërpreu rrymën.**

kulminant, ~e mb., FGJSSH e ka këtë fjalë të huaj, e cila ka hyrë në gjuhën tonë nga gjuhët neolatine. Në vend të saj përdoret fjala **kulmor, ~e**, p.sh.: *Pjesa kulmore. Pika kulmore e shfaqjes.* Në togun **pika kulminante** fjala e huazuar zëvendësohet, sipas rastit. edhe me **e lartë**; mund të zëvendësohet edhe i gjithë togu me emrin **kulmi**, p.sh.: *Beteja kishte arritur pikën më të lartë (Beteja kishte arritur kulmin) në vend të Beteja kishte arritur pikën kulminante. Ajo kishte arritur pikën më të lartë (Ajo kishte arritur kulmin) në vend të Ajo kishte arritur pikën kulminante.*

kundërofensiv/ë, ~a f., sh. ~a, ~at. Shih tek **ofensiv/ë, ~a.**

kurioz, ~e mb., kuriozitet, ~i m. Janë fjalë të huaja të panevojshme që kanë hyrë në gjuhën shqipe nga gjuhët neolatine, prandaj edhe FGJSSH nuk i ka. Mbiemri **kurioz** ka si kuptim të parë “që ka si dëshirë të madhe për të parë diçka, për të mësuar një të fshehtë, për të hyrë në hollësira etj.” dhe si kuptim të dytë me ngjyrim keqësues “që është i prirur të dijë edhe gjëra që nuk i përkasin dhe që nuk kanë të bëjnë me të”. Fjala **kuriozitet** përdoret me kuptimin “dëshirë e madhe për të parë diçka, për të hyrë në hollësira etj. (edhe me ngjyrim keqësues). Në vend të këtyre fjalëve sot përdoren përkatësisht fjalët shqipe **kureshtar, ~e** dhe **kureshtje, ~ja, kërshëri, ~a**, p.sh.: *Njeri kureshtar. Është (tregohet) kureshtar. E bëri kureshtar. Ka kureshtje. Shuaj kureshtjen.* Mbiemri **kureshtar** përdoret edhe me kuptimin “ai që ka kureshtje”, p.sh.: *Ishin mbledhur shumë kureshtarë.* Edhe trajta e shumësit **kuriozite** me kuptimin “diçka që të ngjall kureshtje” mund të zëvendësohet me fjalën **kureshti, ~të**, p.sh. *Kureshtitë shkencore. Vizitoi kureshtitë e vendit (e qytetit) etj.* (Fjala **kuriozitet** ka edhe këto kuptime: që ndodhë rrallë, diç jo e rëndomtë, e jashtëzakonshme, veçanti, çuditshmëri; gjë e rrallë, gjë interesante, gjë e denjë për t’u parë MD).

lavatriçe, ~ja f. Kjo fjalë e huaj që ka hyrë në gjuhën shqipe nga italishtja, zëvendësohet me togfjalëshin **makinë larëse** ose edhe vetëm **larëse**. E ka edhe FGJSSH, p.sh.: *Fut rrobat në makinë larëse. Prodhimi i makinave larëse.* (Këto propozime nuk janë me vend, meqë **lavatriçe** ka kuptimin e ngushtë për **makinën e larjes së rrobave**, kurse, në anën tjetër, kemi edhe **makinën për larjen e enëve**, prandaj **makinë larëse** ka kuptim të gjerë dhe nuk mund ta zëvendësojë fjalën **lavatriçe** e lëre më të thuash vetëm **larëse**, ku mund të nënkuptohet edhe njeriu si larës i rrobave dhe i enëve. MD).

legjislativ, ~e mb. Për këtë fjalë të huaj FGJSSH të çon te fjala shqipe **ligjvënës, ~e**, e cila e ka zëvendësuar atë në të dy kuptimet e saj: 1) “që ka të drejtën të nxjerrë e të vendosë ligje” dhe 2) “që merret me hartimin e ligjeve”. Në vend të fjalës së huazuar **legjislativ** takohet edhe termi **ligjdhënës**, i cili nuk është i nevojshëm, sepse termi **ligjvënës** i mbulon plotësisht kuptimet e fjalës së huazuar, p.sh.: *Organ ligjvënës. Pushteti ligjvënës. Veprimtari ligjvënës.*

leguminoze, ~t *vet. sh.*, **leguminoz**, ~e *mb.* Terma të botanikës me burim nga gjuhët neolatine; nuk jepen në FGJSSH. Emri **leguminoze**, ~t, ka kuptimin “familje bimësh, e cila përmbledh barishte, shkurre ose drurë që ë kanë frytin bishtajë”; këtu hyjnë, p.sh. bizelet, bathët, fasulet, thjerrëzat, qiqrat etj. Në vend të emrit **leguminoze**, ~t FGJSSH jep fjalën **bishtajore**, ~t, p.sh.: *Familja e bishtajoreve. Bishtajore njëvjeçare (shumëvjeçare)*. Mbiemri **leguminoz**, ~e është zëvendësuar me fjalën shqipe **bishtajor**, ~e (“që e ka frytin bishtajë a si bishtajë”), pra, thuhet: *Bimët bishtajore. Perimet bishtajore.*

literatur/ë, ~a *f., sh.* ~a, ~at. Fjalë e huazuar nga gjuhët neolatine. E ka edhe FGJSSH, por pa shpjegim. Në vend të saj këshillohet fjala letërsi. Fjala e huaj duhet zëvendësuar vetëm në kuptimin “tërësia e veprave të shkruara që kanë të bëjnë me një nga fushat e dijes ose që trajtojnë një çështje të caktuar”, që përdoret ende, p.sh.: *Letërsi politike (shkencore, teknike, mjekësore, pedagogjike, gjuhësore, historike). Letërsia për Skënderbeun. Letërsia për rritjen e gjedhit (për bletarinë, për pemëtarinë, për sëmundjet e fëmijëve)*. Në kuptimet e tjera (“krijimtari letrare, lloj arti etj.”) ajo është zëvendësuar me kohë.

medicin/ë, ~a *f.*, **medicinal**, ~e *mb.* Fjalë të huaja që kanë hyrë në shqipen e shkruar nga gjuhët neolatine. Në vend të tyre përdoren prej kohësh fjalët **mjekësi**, ~a dhe **mjekësor**, ~e. Tashmë edhe në botimet e shkencës së mjekësisë, me të drejtë, u është dhënë përparësi formimeve shqipe. Kështu tani lexojmë rregullisht: *Mjekësia ligjore. Mjekësia sportive. Studion për mjekësi. Sapun mjekësor. Bimë mjekësore. Qendër mjekësore.*

medikolegal, ~e *mb.* Në vend të kësaj fjale të përbërë nga dy tema të huaja, po përdoret që prej disa vjetësh formimi shqip **mjekoligjor**, ~e. Kështu thuhet: *Komisioni mjekoligjor. Shqyrtim mjekoligjor.*

megaloman, ~e *mb.* **megalomani**, ~a *f.*, janë dy fjalë të huaja që përdoren kryesisht në stilin libror. FGJSSH i çon përkatësisht te fjalët **mendjemadh**, **mendjemadhësi**, p.sh.: *Njeri mendjemadh* (në vend të: *Njeri megaloman*). Është *mendjemadhe*. *Shenja mendjemadhësie. Flet me mendjemadhësi*. (Kuptimi kryesor i kësaj fjale është: *harbim, dëshirë e tepruar për një gjë; trenia – marrëzia e madhështisë, madhështi e përfytyruar, mbivlerësim i sëmurë i vetvetes etj.*, prandaj kjo fjalë nuk mund të zëvendësohet vetëm me fjalën **mendjemadhësi** MD).

-metër Fjalë me burim nga greqishtja e vjetër, që përdoret edhe si gjymtyrë e dytë në shumë fjalë të përbëra me kuptimin “masë, matës”, p.sh.: *barometër, gazometër, goniometër, gjeometër, kalorimetër. manometër, perimetër, termometër* etj. Një pjesë e këtyre fjalëve, që kanë hyrë si terma me përdorim ndërkombëtar, përdoren edhe në gjuhën shqipe p.sh. *barometër, gjeometër, kilometër, termometër* etj. kurse pjesa tjetër, me të cilën

emërtohen veglat dhe aparatet teknike, është zëvendësuar me fjalë shqipe. Kështu p.sh., FGJSSH këshillon të përdoret: **gazmatës** në vend të **gazometër**, **nxehtësimatës** në vend të **kalorimatës**, **këndmatës** në vend të **goniometër**, **dendësimatës** në vend të **densimetër**.

mizeri/e, ~a *f.* FGJSSH nuk e ka këtë fjalë të huazuar nga gjuhët neolatine, sepse kemi fjalën shqipe **mjerim** për kuptimet themelore përkatëse: **Mjerim** *i madh*. *Jetonte në mjerim*. *Shpëtuan nga mjerimi*. Edhe si sharje, në përdorime të tilla, si: *Ik, or mizerie! Ç'mizerie!* etj., që i takojnë ligjërimin të thjeshtë dhe nuk janë të gjuhës letrare, fjala e huaj mund të zëvendësohet me fjalë të shqipes (*fig. i keq, i ndyrë, i poshtër*): *Ik, or i lig (i poshtër)! Sa i poshtër (i ndyrë, i lig, i keq)!*

monstër, ~ra *f.*, **monstruoz, ~e** *mb.* Të dyja këto fjalë me prejardhje nga gjuhët neolatine nuk jepen në FGJSSH. Emri **monstër** në gjuhën tonë është përdorur me disa kuptime, që i mbulon plotësisht fjala shqipe **përbindësh**. Këtë e këshillon të përdoret edhe A. Xhuvani (në veprën: “Për pastërtinë e gjuhës shqipe”). Edhe mbiemri **monstruoz** (që përdoret në kuptimet 1) “Që ka përmasa jashtëzakonisht të mëdha, që të kall tmerrin”; 2) *fig. keq*. “Shumë i shëmtuar e i neveritshëm, që bëhet me egërsi të madhe”), zëvendësohet plotësisht me fjalën shqipe **i përbindshëm**. P.sh: *Qenie e përbindshme. Krime të përbindshme.*

monument, ~i *m.*, **sh. ~e, ~et**. Fjalë e huazuar nga gjuhët neolatine. Në kuptimet “vepër arkitekture ose skulpturë e ngritur në një vend për të përjetësuar kujtimin e një ngjarjeje historike a të një njeriu të shquar”, dhe “vepër e shkruar, që ka vlera të veçanta historike, kulturore, shkencore etj.” ka hyrë në përdorim fjala shqipe **përmendore**, p.sh.: **Përmendorja e Partizanit (e Skënderbeut)**. *I ngritën një përmendore. Përmendoret e para të shkrimit të shqipes. Poema “Bagëti e bujqësi” është përmendore e pavdekshme*. Edhe në kuptimin “ndërtesë a vepër tjetër arti (urë etj.) e vjetër e me vlera artistike ose historike” mund të zëvendësohet po me fjalën **përmendore**, p.sh.: **Përmendore historike. Përmendore arkitekture. Instituti i Përmendoreve të Kulturës. Mbrojtja e përmendoreve. U shpall përmendore kulture.**

mortalitet, ~i *m.* Fjalë e huazuar nga frëngjishtja. Është përdorur kryesisht në fushën e mjekësisë. Në vend të saj ka hyrë në përdorim fjala **vdekshmëri, ~a**, të cilën e këshillon edhe FGJSSH. Fjala shqipe **vdekshmëri, ~a** e mbulon fjalën e huaj në të gjitha kuptimet dhe përdorimet, p.sh.: **Vdekshmëri e lartë (e ulët). Ulja e vdekshmërisë.**

neglizhoj *kal.* dhe **jokal.**, **neglizhenc/ë, ~a** *f.* Fjalë me temë të huazuar nga frëngjishtja. Në FGJSSH nuk janë dhënë. Fjala **neglizhoj** mund të zëvendësohet me disa shprehje shqipe sipas kuptimeve ose lidhjeve të saj me fjalë të tjera. P.sh.: **Nuk kam kujdes. Nuk i vë kujdes. Lë pas dore** (të cilat i

këshillon edhe A. Xhuvani në veprën e tij “Për pastërtinë e gjuhës shqipe”): **shmanget**, p.sh.: *Ai lë pas dore detyrën. Nuk duhet lënë pas dore. Ai nuk i vë kujdes.* Fjalën *neglizhencë* e zëvendësojnë fjalët shqipe **pakujdesi**, *mungesë kujdesi*, p.sh. *Pakujdesi në punë. Ndodh (vjen) nga pakujdesia a mungesa e kujdesit*, por shqipja ka edhe mënyra të tjera të themi që e mënjanojnë fare këtë fjalë. P.sh.: *Nuk ia vë veshin punës. Nuk tregoi kujdes në punë.*

novacion, ~i *m., sh. ~e, ~et.* Huazim nga gjuhët neolatine. E ka edhe FGJSSH. Nganjëherë në botime të ndryshme, sidomos në shtypin e përditshëm, ka dalë edhe në trajtën **inovacion**. Kuptimi kryesor i kësaj fjale është “metodë e re në prodhim ose në teknikë, diçka e re e përparimtare në fushën e shkencës a të artit”. Në këtë kuptim zëvendësohet me fjalën e shqipes **risi**, p.sh.: *Risi gjuhësore. Risi letrare.*

ofensiv/ë, ~a *f., sh. ~a, ~at.* Është fjalë me burim nga gjuhët neolatine. Përdoret kryesisht në terminologjinë ushtarake, por edhe në fusha të tjera me kuptim të figurshëm. Është përfshirë edhe në FGJSSH, por aty jepet njëherazi edhe fjala shqipe **mësymje**, e cila e zëvendëson atë në të gjitha kuptimet e përdorimit: *Mësymje e përgjithshme. Mësymje ushtarake. Kaluan (u hodhën) në mësymje. Nisën mësymjen.* Edhe fjala **kundërofensivë** zëvendësohet me fjalën **kundërmësymje**, ~a: *Kundërmësymja e ushtrisë Nacionalçlirimtare. Filloi kundërmësymja e përgjithshme. U hodhën në kundërmësymje.*

okllai, ~ia *f., sh. ~, ~të.* Fjalë me prejardhje nga turqishtja, që në disa të folme të shqipes ka marrë trajta të ndryshme. Në vend të kësaj fjale të huaj në gjuhën letrare përdoret e duhet të përdoret fjala **petës**, ~i, që është me burim popullor, p.sh.: *E tëholli me petës.*

orator, ~i *m., sh. ~ë, ~ët; oratori*, ~a *f.; oratorik*, ~e *mb.* Janë fjalë të huaja me burim nga gjuhët neolatine. FGJSSH i cilëson si fjalë librore dhe në vend të shpjegimit jep fjalët shqipe përkatëse: **gojëtar**, ~i (femërore e saj **gojëtar/e**, ~ja); **gojëtari**, ~a; **gojëtar**, ~e, p.sh.: *Është gojëtar i madh. Shquhet si gojëtar (gojëtare). Art i gojëtarisë. Gojëtaria është arti i të folurit bukur e rrjedhshëm. Aftësi gojëtare.* Siç shihet, fjalët shqipe i mbulojnë fjalët e huaja në të gjitha kuptimet dhe përdorimet.

parantez/ë, ~a *f.* Fjalë me burim nga greqishtja e vjetër që ka hyrë në gjuhën shqipe nëpërmjet frëngjishtes. FGJSSH e jep këtë fjalë me dy kuptime. Kur përdoret me kuptimin e parë “Shenjë pikësimi, e përbërë nga dy viza të harkuara, ku përfshihen fjali sqaruese në mes të një fjalie; shenjë e tillë që përdoret në veprimet matematike”, zëvendësohet me termin **klapë**, ~a, p.sh.: *Hap (mbyll) kllapat. Vë midis kllapave (ndër kllapa). Kllapa katrore.* Kur përdoret me kuptimin e dytë “Fjalët ose fjalitë që thuhet si diçka e ndërmyetme a anësore, jo të lidhura drejtpërdrejt me fillin themelor të shtjellimit të mendimit”, fjala **porantezë** zëvendësohet me ndërtime e togje të

tjera të shqipes që përdoren me kuptim të përafërt, p.sh.: *E tha kalimthi, ndërmjet të tjerash*, në vend të: *E tha në parantezë*.

parcel/ë, ~a f., parceloj kal., parcelim, ~i m. Fjala parcelë është huazuar nga italishtja. FGJSSH e ka këtë fjalë, por nuk e shpjegon dhe e çon te fjala shqipe **ngast/ër, ~ra**, e cila ka marrë përhapje të gjerë, p.sh.: *Ngastër e madhe (e vogël)*. Kullimi i *ngastrave*. *Ngastrat e misrit (e grurit, e pambukut)*. Kuptimet dhe përdorimet e fjalëve të prejardhura **parceloj** dhe **parcelim** mbulohen me togjet e shqipes **ndaj (tokën) në ngastra** dhe **ndarja (e tokës) në ngastra** ose me fjalët **ngastëroj, ngastërim**.

pastiçeri, ~a f. pastiçer, ~e mb. Të dyja këto fjalë të huaja kanë hyrë në gjuhën shqipe nga italishtja. Në vend të emrit **pastiçeri** ka kohë që në shqipen përdoret fjala **ëmbëltore**. FGJSSH nuk e shpjegon këtë fjalë, por e çon te fjala shqipe **ëmbëltore**. Ja një varg shembujsh ku fjala shqipe **ëmbëltore** përdoret në vend të fjalës së huaj **pastiçeri**: *Hynë në një ëmbëltore. Ëmbëltore “Rinia”. Ëmbëltore “Tirana”*. Fjala **pastiçer** përdoret me kuptimin “ai që merret me gatimin e ëmbëlsirave, ai që bën ëmbëlsira”. Në këtë kuptim kjo fjalë e huazuar mund të zëvendësohet me shqipen **ëmbëltar** (Fjala **ëmbëltar** nuk është në FGJSSH, në vend të kësaj duhet përdorur **ëmbëlsirashitës** MD). Ja disa shembuj: *Punon si ëmbëltar*. Është **ëmbëltar i dalluar**.

penetroj kal., penetrim, ~i m., penetrues. ~e mb. Këto fjalë, me temë nga gjuhët neolatine, nuk jepen në FGJSSH, sepse janë zëvendësuar tashmë me fjalët shqipe **depërtoj, depërtim, depërtues**, p.sh.: *Ushtritë armike nuk depërtuan dot në prapavija. Depërtim ushtarak. Depërtim ideologjik*. (Kjo fjalë ka edhe këto kuptime **penetrim**: fuqi depërtuese, mendjehollësi, mendjemprehtësi, aftësi për të hyrë në thelbin e gjërave; **penetroj**: hyj, futem, përshkoj, infiltrohem, shpërthej; shoh tej përtej, shoh nëpër; *fig.* blej mendjen, tejskoh; shoh në fund të fundit; kuptoj, marr vesh; hetoj, vëzhgoj etj. MD).

perfeksionoj kal., perfeksionohem vetv., perfeksionim, ~i m. Këto fjalë me temë nga gjuhët neolatine nuk i jep FGJSSH. Kuptimi kryesor i fjalës **perfeksionoj** është “bëj diçka më të mirë nga ç’ka qenë, duke synuar të mos ketë asnjë të metë; përsos”. Zëvendësohet me fjalët shqipe **përsos, përkryej**. p.sh.: *Përsos (përkryej) metodën e punës (stilin në punë)*. *Ka përsosur (përkryer) gjuhën etj.* Edhe fjalët **perfeksionohem, perfeksionim** zëvendësohen përkatësisht me **përsosem, përsosje**, p.sh.: *Përsoset teknika. Çdo ditë edukohemi, mësojmë, kalitemi e përsosemi. Përsosja e mëtejshme e planifikimit të bujqësisë. Përsosja e metodës dhe e stilit në punë etj.*

personal, ~e mb. Fjalë e huazuar nga gjuhët neolatine. Ka filluar të zëvendësohet në të gjitha kuptimet dhe përdorimet me fjalën shqipe **vetjak**,

~e, p.sh.: Pronë **vetjake**. Interesi **vetjak**. Çështje **vetjake**. Higjiena **vetjake**. Jep shembullin **vetjak**. Sende **vetjake**. Basketbollistët bënë pak gabime **vetjake**.

petal, ~i m. Fjalë e huaj e fushës së botanikës që emërton “secilën nga fletëzat e holla me ngjyra, që përbëjnë kurorën e një luleje”. Në këtë kuptim kjo fjalë është zëvendësuar me fjalën shqipe **pet/ël**, ~la, p.sh.: **Petël e kuqe**. **Petlat e trëndafililit**. I ranë **petlat**.

predominioj kal., **predominim**, ~i m., **predominues**, ~e mb. Edhe këto fjalë nuk jepen në FGJSSH. Fjala **predominioj** me burim gjithashtu nga gjuhët neolatine, ka kuptimin “kam epërsi, zotëroj mbi të tjerët, sundoj mbi të tjerët, shquhem më shumë”, dhe zëvendësohet fare mirë në gjuhën tonë me fjalët **mbizotëroj**, **mbisundoj**, p.sh.: Në brigadë **mbizotërojnë** gratë. Në vepër **mbisundojnë** elementet e motiveve popullore. Në fshat para Çlirimit **mbisundonin** marrëdhëniet gjysmëfeudale. Në vendin tonë **mbizotëron** popullsia fshatare. Kudo **mbizotëron** fryma e aksionit. Emri **predominim** zëvendësohet me **mbizotërim**, **mbisundim**. p.sh.: **Mbizotërim** i thellë (i madh, i dukshëm). **Mbizotërim** i metodave revolucionare. **Mbisundimi** i industrisë së rëndë. **Mbisundimi** i së kuqes mbi ngjyrat e tjera. Edhe mbiemri **predominues** zëvendësohet me **mbizotërues**, **mbisundues**, p.sh.: **Forcë mbizotëruese**. Sektor **mbizotërues**. Ide **mbisunduese**. Tipar **mbisundues**.

preferoj kal., **preferohem pës.**, **preferim**, ~i m., **preferenc/ë**, ~a f., **preferuar** (i, e) mb. Foljen **preferoj** (**preferohem**), me temë të huazuar nga gjuhët neolatine, FGJSSH e cilëson si fjalë librore dhe në vend të shpjegimit jep fjalët dhe shprehjet shqipe **parapëlqej**. **pëlqej më shumë**, p.sh.: **Parapëlqen** (**pëlqen më shumë**) mendimin tënd. **Parapëlqejmë** (**pëlqejmë më shumë**) lojërat me dorë. Në ligjërimin bisedor në këtë kuptim përdoret edhe shprehja **kam qejf më shumë**, p.sh.: **Është gjella që kam qejf më shumë**. Fjalët **preferim** dhe **i preferuar**, që janë formuar nga tema foljore, zëvendësohen nga fjalët **parapëlqim** dhe (i, e) **parapëlqyer**, p.sh.: **Parapëlqimi** i kësaj lidhet me vetitë që ka. **Rrushi, molla, portokalli, mandarina janë nga frutat më të parapëlqyera**. Me fjalën shqipe **parapëlqim**, në kuptimin “prirje që kemi ndaj dikujt a diçkaje, që më pëlqen më shumë se të tjerët a të tjerat; mendimi paraprak që jep dikush se e pranon dikë a diçka, miratim, pëlqim paraprak”, mund të zëvendësohet edhe fjala **preferencë** që është huazuar nga italishtja, p.sh.: **Sipas parapëlqimit të secilit**. Nuk është ecur me **parapëlqime**.

presion, ~i m. Është fjalë e huaj me prejardhje nga gjuhët neolatine. Në vend të saj FGJSSH ka dhënë fjalën shqipe **trysni**, ~a (që është si term në fizikë) me kuptimin “forca e shtypjes që ushtron një trup i ngurtë, i lëngët a i gaztë me peshën ose me forcën e tij mbi një trup tjetër; shtypje, presion”. Pra thuhet: **Trysnia e ajrit**. **Trysnia atmosferike**. **Trysnia e gjakut**. Në kuptimin e

dytë “ndikim që ushtrohet me forcë kundrejt dikujt, shtrëngim për ta detyruar të veprojë ashtu siç dëshiron një tjetër, forca që ushtrohet kundrejt diçkaje, trysni” kjo fjalë përdoret, por, siç shihet nga shpjegimi, FGJSSH jep krahas saj edhe me këtë kuptim fjalën **trysni**, **~a**, e cila ka filluar aty-këtu ta zëvendësojë fjalën **presion** edhe me kuptim të figurshëm, p.sh.: **Trysni ekonomike (politike, ideologjike)**. **Ushtron trysni**. Ky përdorim ka filluar të zgjerohet duke u shtrirë edhe në fusha të tjera.

prezentoj kal., **prezentohem vetv.**, **prezentim**, **~i m.** Fjalë me temë të huazuar nga gjuhët neolatine. Përdoret pa nevojë sidomos në ligjërimin bisedor. FGJSSH nuk i ka këto fjalë dhe në vend të tyre jep fjalët dhe togjet e fjalëve shqipe, përkatësisht: **paraqit**, **njoh me**; **paraqitem**, **njihem me**; **paraqitje**, **njohje**. p.sh.: *Po ju **paraqit** (po ju **njoh**). Ia **paraqiti** vëllait (**E njohu me vëllanë**). **Të paraqitemi** (të **njihemi**). **Po paraqitem** edhe unë. **Paraqitja** te eprori.*

primar, **~e mb.** Fjalë librore me prejardhje nga gjuhët neolatine. FGJSSH fjalën **primar**, **~e** e jep pa shpjegim, duke e çuar te fjala shqipe **parësor**, **~e**, e cila e zëvendëson plotësisht fjalën e huaj, p.sh.: *Kuptimi **parësor**. Dukuri **parësore**. Trajta **parësore**.*

produktiv, **~e mb.**, **produktiv**, **~i m.** Kanë hyrë në gjuhën shqipe nga gjuhët neolatine. Në vend të mbiemrit **produktiv**, që ndeshet më shumë në ligjërimin letrar, përdorim fjalët **prodhues**, **prodhimtar** dhe **i frytshëm**, **frytdhënës**, p.sh.: *Është shumë **prodhimtar**. Punë e **frytshme** (**frytdhënëse**). **Ekonomi (degë) prodhimore**. Vit **prodhimtar**. **Prapashtesë prodhimore**. Tokë **prodhimore**. Për **produktivitet** FGJSSH në vend të shpjegimit jep sinonimin shqip **prodhimtari**, p.sh.: *Rritja e **prodhimtarisë** së tokës. Të ngremë më tej shkallën e **prodhimtarisë**.**

progres, **~i m.**, **progresist**, **~e mb.** Kjo çerdhe fjalësh, që zë fill nga një temë e burimit latin, përdoret kryesisht në gjuhën librore. Fjalën **progres**, të cilën FGJSSH e shpjegon: “prirje e përgjithshme zhvillimi, ecje përpara, kalim në një shkallë më të lartë, përparim”, e zëvendëson fjala shqipe **përparim**, të cilën edhe FGJSSH e jep si sinonim pas shpjegimit, p.sh.: ***Përparim** ekonomik (shoqëror). Ne rrugën e **përparimit**. Mbiemrin **progresist** FGJSSH nuk e shpjegon, por e jep me referim te fjala shqipe **përparimtar**, që e zëvendëson plotësisht në të gjitha kuptimet e përdorimet, p.sh.: ***Forcat përparimtare**. **Mendimi përparimtar**.**

progresiv, **~e mb.** Edhe kjo fjalë e huaj, me burim latin, përdoret kryesisht në gjuhën librore. Mund të zëvendësohet, sipas rastit, me fjalën shqipe **i përparuar** e **përparues**, p.sh.: *Mesatarja e **përparuar**. Norma të **përparuara**. Farma **përparuese** e sëmundjes.*

proporcion, **~i m.** **proporcional**, **~e mb.** **disproporcion**, **~i m.** Këto fjalë

të huaja, siç këshillon edhe “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe”, zëvendësohen përkatësisht me fjalët shqipe **përpjesëtim**, **~i**, **përpjesëtimor**, **~e** dhe **shpërpjesëtim**, **~i**, p.sh.: *Madhësi përpjesëtimore. Zhdukja e shpërpjesëtimeve* etj.

radikal, **~e** mb., **radikalisht** ndajf. Fjalë me temë nga gjuhët neolatine. FGJSSH nuk i ka këto fjalë, sepse në vend të tyre kemi fjalët shqipe **rrënjësor** dhe **rrënjësisht**: *Ndryshim (përmirësim) rrënjësor. Shndërrim rrënjësor. Në mënyrë rrënjësore. E pastroi rrënjësisht. Ndryshoi rrënjësisht.*

reciprok, **~e** mb. Fjalë e huaj me prejardhje nga gjuhët neolatine. FGJSSH jep si kuptimet e saj, ashtu edhe sinonimet shqipe: **i ndërsjellë**, **i dyanshëm**, **i shoqishoqëm**. Këto vitet e fundit, si në shtyp, ashtu edhe në radiotelevizion etj., fjala e huaj **reciprok** po zëvendësohet gjithnjë e më tepër me fjalën shqipe **i ndërsjellë**, pra: *Lidhje (marrëdhënie) të ndërsjella. Ndikim i ndërsjellë. Huazime të ndërsjella. / gjuh. Ndhimë e ndërsjellë / drejt. Mirëkuptim (besim) i ndërsjellë. Dëshirë e ndërsjellë. Edhe fjala reciprocitet, që gjithashtu ka një përdorim të gjerë si fjalë e huaj, mund të zëvendësohet me fjalën shqipe **ndërsjellës, ~a**, p.sh. *Parimi i ndërsjellësisë. Vë kushte mdërsjellësie.**

refraktar, **~e** mb. Kjo fjalë ka hyrë në gjuhën shqipe nga gjuhët neolatine. E ka edhe FGJSSH me dy kuptime. Kur përdoret si term në teknikë, me kuptimin “që nuk shkrihet a nuk prishet në nxehtësi të madhe, që e duron zjarrin; që është karakteristik për lëndët, të cilat e durojnë nxehtësinë e madhe”, kjo fjalë zëvendësohet me fjalën shqipe **zjarrduruës**, **~e**. që e mbulon plotësisht kuptimin e saj, p.sh.: *Tulla zjarrduruëse. Çelik zjarrduruës. Lëndë (veshje) zjarrduruëse. Ka veti zjarrduruëse.* Në kuptimin e figurshëm “që nuk pranon ndryshime, që kundërshton ndikimet, të cilat kërkojnë ndonjë ndryshim; që nuk tregohet i gatshëm për të pranuar a për të marrë një ide a një teori të re, një zakon të ri etj.”, fjala **refraktar** i përket stilit libror dhe nuk ka përdorim të dendur: *Qëndrim refraktar. Njeri refraktar.* Megjithatë, edhe në këtë kuptim mund të bëhet përpjekje për ta zëvendësuar.

refuzoj kal., **refuzohet** pës., **refuzim**, **~i** m. Çerdhe fjalësh me temë të huazuar nga gjuhët neolatine. A. Xhuvani këshillonte që në vend të huazimit **refuzoj** të përdorim “*e kthej, kthej prapë, e hedh tej, e mohoj, nuk e qas, nuk e dëgjoj, nuk e dua*”. Edhe FGJSSH e jep me fjalë të shqipes. si: “*nuk e pranoj, hedh poshtë, nuk e dua, kundërshtoj*, p.sh. *Nuk e pranoi (e hodhi poshtë, e kundërshtoi) kërkesën (urdhrin, fjesën). Nuk pranoi ta bënte (të vinte, të shkonte, të fliste). Nuk e pranoi dhuratën. Refuzim* zëvendësohet me **mospranim, hedhje poshtë, kundërshtim**.

sakrifikoj kal., **sakrifikohem** vetv., **sakrifikim**, **~i** m., **sakrifikuar** (i, e) mb. Kjo çerdhe fjalësh gjendet edhe në FGJSSH. Fjala **sakrifikoj** është prejardhje

nga italishtja. Kuptimi i saj është “jap jetën për dikë a për diçka; nuk e kursej ose e lë të humbasë dikë a diçka për të arritur një qëllim; heq dorë nga diçka për hir të një qëllimi ose në të mirë të dikujt”. Pra, ajo mund të zëvendësohet me fjalët e gjuhës shqipe flijoj, therorizoj ose me togfjalëshat bëj fli, bëj theror, p.sh.: **Flijoj veten (jetën) për të mirën e atdheut. Flijoi rininë e tij.** E gjithë çerdhja mund të zëvendësohet me fjalët e prejardhura: **flijohem, therorizohem; bëhem fli, bëhem theror; flijim, therorizim; i flijuar, i therorizuar**, p.sh.: *U flijua për lirinë e vendit të tij. Flijimi i interesit vetjak për të mirën e përgjithshme.*

sekondar, ~e mb. Fjale librore, me prejardhje nga gjuhët neolatine. FGJSSH nuk e ka këtë fjalë, po jep në vend të saj fjalën shqipe **dytësor, ~e** me dy kuptime: 1) “që vjen pas një tjetri dhe varet prej tij, që përcaktohet nga një tjetër: kund. **parësor**” dhe 2) “që është në vend të dytë, që është i dorës së dytë, jokryesor”. P.sh.: *Materia është parësore, ndërgjegjja dytësore. (?) Rrugë dytësore. Lëndë dytësore. Kanale dytësore.*

seleksionoj kal., seleksionohet pës., seleksionim, ~i m., seleksionuar (i, e) mb. Çerdhe fjalësh me temë të huazuar nga gjuhët neolatine. Kuptimin e foljes **seleksionoj** (“Zgjedh sipas një kriteri të caktuar gjërat më të mira ose individët më të përshtatshëm për diçka”) FGJSSH, me të drejtë, e jep me sinonimin shqip **përzgjedh**. E gjithë çerdhja mund të zëvendësohet me fjalë shqipe të prejardhura nga folja e mësipërme, të cilat japin në mënyrë të përpiktë si kuptimet e përgjithshme të çerdhes me bazë të huaj, ashtu edhe ato terminologjike. Pra, mund të përdorim: **përzgjedh, përzgjidhet, përzgjedhje, i përzgjedhur**. P.sh.: *Përzgjedhin mallrat për shitje. Përzgjidhen farërat për mbjellje. Përzgjedhja artificiale (në bujqësi). Përzgjedhja e futbollistëve më të mirë. Bëj përzgjedhjen. Xeherorët e përzgjedhur.*

sepal, ~i m. Fjalë e huaj e fushës së botanikës, që emërton secilën nga gjethëzat, zakonisht të blerta, që përbëjnë kupën e lules”. Në këtë kuptim kjo fjalë është zëvendësuar në tekstet shkollore, ashtu siç këshillojnë “Fjalori i botanikës” dhe FGJSSH me fjalën shqipe **nënpetël**. P.sh.: *Nënpetla e lules. Lule me katër nënpetla. Petlat dhe nënpetlat.*

silvikultur/ë, ~a f. Term i bujqësisë, me prejardhje nga gjuhët neolatine, ashtu si edhe terma të tjerë të kësaj fushe, që kanë si gjymtyrë të dytë fjalën **kulturë**. Prej kohe është zëvendësuar me fjalën shqipe **pylltari, ~a** (ashtu si **apikulturë, frutikulturë, hortikulturë, olivikulturë, vitikulturë** janë zëvendësuar me fjalët shqipe **bletari, pemëtari, kopshtari, ullishtari, vreshtari**). Edhe FGJSSH e jep këtë fjalë pa shpjegim, duke e çuar te fjala pylltari, p.sh.: *Zhvillimi i pylltarisë. Fakulteti i pylltarisë. Dega e pylltarisë. Kurs për pylltari.*

spektator, ~i m. Fjalë e huaj që ka hyrë në shqipen nga gjuhët neolatine.

Në vend të saj po përdoret me të drejtë fjala shqipe **shikues**. P.sh.: *Shikues i rregullt i teatrit (i kinemasë, i shfaqjeve). Duartrokitjet e shikuesve. Vende për shikues*. Po kështu, në këtë kuptim, edhe fjala **telespektator** duhet zëvendësuar me fjalën **teleshikues**, p.sh.: *Mijëra teleshikues i ndoqën ndeshjet*.

spontan, ~e mb. Fjalë e huaj, me prejardhje nga gjuhët neolatine. FGJSSH e ka si fjalë librore. Kuptimet e saj mbulohen me fjalën shqipe **vetvetishëm**, p.sh. *Veprim i vetvetishëm. Pjesëmarrje (lëvizje, kryengritje) e vetvetishme. Në mënyrë të vetvetishme. Prirje (dëshirë) e vetvetishme. Bimësi e vetvetishme*. Edhe fjala e prejardhur, e formuar me prapashtesën **-isht**: **spontanisht** ndajf. mund të zëvendësohet me fjalë e shprehje të shqipes, si **vetvetiu** (ose thjesht **vetiu**), *në mënyrë të vetvetishme*, p.sh.: *Mbinë vetvetiu. Lindi vetvetiu (ose në mënyrë të vetvetishme). U shfaq vetvetiu. Dijet nuk vinë vetvetiu*.

stabilitet, ~i m. Fjalë e huaj me prejardhje nga gjuhët neolatine. Kjo fjalë në të kaluarën është përdorur dendur e po përdoret ende pa nevojë në shtyp e në publicistikë. FGJSSH e jep këtë fjalë pa shpjegim, duke e çuar te fjala shqipe **qëndrueshmëri**, e cila e zëvendëson plotësisht në të gjitha kuptimet e përdorimet. Prandaj, në vend të *Stabiliteti ekonomik (politik). Faktor stabiliteti* etj., duhet të përdoret **Qëndrueshmëri ekonomike (politike). Faktor qëndrueshmërie. Qëndrueshmëria e çmimeve**.

tarracë, ~a f., **tarracoj** kal., **tarracim**, ~i m. ...(mungojnë dy faqe) *Tarracat e shtëpive (e pallateve). Shtëpi me tarracë. Dal në tarracë. Shoh nga tarraca*. Në këtë kuptim kjo fjalë, si term i arkitekturës, nuk është zëvendësuar, por për kuptimin e saj të dytë “Brez toke i gjatë e i sheshtë, që hapet në faqe të malit a të kodrës dhe që shërben për të mbjellë pemë e bimë të tjera” prej kohësh ka hyrë në përdorim të gjerë fjala shqipe **brezar/e, ~ja** f., të cilën e ka edhe FGJSSH si sinonim të kuptimit 2 të fjalës **tarracë**, p.sh.: *Brezaret e Vlorës (e Sarandës). Mal me brezare. Hapin brezare të reja. Brezare me agrume (me ullinj)*. Edhe folja e prejardhur **tarracoj** dhe emri i formuar prej saj **tarracim** janë zëvendësuar me **brezaroj, brezarim**, p.sh.: *Brezarojnë kodrat. Brezarimi i shpateve të malit*.

tekstualisht ndajf. Kjo fjalë e huaj, formuar me prapashtesën **-isht** nga tema **tekstual** me prejardhje nga gjuhët neolatine, ka kuptimin “Siç është (thënë e shkruar) në tekst”. Nuk është përfshirë në FGJSSH, sepse për të shprehur kuptimin e saj në shqipen, kemi togjet **fjalë për fjalë** dhe **pikë për pikë**, që përdoren sipas rastit, kur riprodhojmë diçka të shprehur me shkrim a me gojë, pa i hequr e pa shtuar gjë, kur përkthejmë diçka nga një gjuhë në tjetrën **fjalë për fjalë**, p.sh.: *Ai ia përsëriti fjalë për fjalë (pikë për pikë), ashtu siç i kishte parë e dëgjuar. Përkthimi është bërë fjalë për fjalë sipas origjinalit. Nxënësi e tha mësimin fjalë për fjalë (pikë për pikë) sipas tekstit*.

Edhe mbiemri **tekstual**, ~e zëvendësohet në gjuhën shqipe me mbiemrin i **fjalëpërfjalshëm**, ose me togun **fjalë për fjalë**, p.sh. *Përkthim i fjalëpërfjalshëm (fjalë për fjalë)*.

transformoj kal., **transformohem** vetv., **transformim**, ~i m., **transformuar** (i, e) mb. Kjo çerdhe fjalësh zë fill nga një temë e burimit neolatin Ajo nuk është përfshirë në FGJSSH, sepse prej kohësh është zëvendësuar plotësisht me fjalët shqipe **shndërroj**, **shndërrohem**, **shndërrim**, **i shndërruar**, p.sh.: *Shndërroj natyrën. Shndërroj ndërgjegjen (shoqërinë). Shtëpi e shndërruar në kështjellë. Shqipëria është shndërruar në një vend me ekonomi të zhvilluar. Shndërrime të thella (rrënjësore). Shndërrime ekonomike (revolucionare). Shndërrimi i energjisë. Dukej krejt i shndërruar.*

transmetoj kal., **transmetohet** pës., **transmetim**, ~i m. Kjo çerdhe fjalësh, me prejardhje nga gjuhët neolatine, gjendet edhe në FGJSSH. Folja **transmetoj** në FGJSSH jepet si fjalë librore. Kuptimi i saj mund të shprehet, sipas rasteve, me disa fjalë të shqipes, si: **kumtoj**, **jap**, **përcjell**, **përçoj**. *Kumtoj* (ose **jap**) një lajm (një urdhër, një porosi, një kërkesë). *ATSH-ja kumtoi* (ose **dha**) këtë deklaratë. *Luteni t'i jepni* (ose t'i **çoni**) përshëndetjet tona. *Rrotat me dhëmbë mbështillen nga zinxhiri, i cili përçjell* (ose **përçon**) lëvizjen. *Kjo lloj përçjelljeje përdoret në biçikletat, motoçikletat dhe traktorët. Radioja dhe televizioni japin këngë popullore* (muzikë, ndeshjen e futbollit). *Dhamë Lajmet*. Po kështu, në vend të **transmetohet** ose **transmetim** mund të përdoren fjalët **jepet** dhe **dhënie**, p.sh.: *Ndeshja do të jepet edhe më anë të televizionit. Dhënia e lajmeve.*

transplantoj kal., **transplantohet** pës., **transplantim**, ~i m., **transplantuar** (i, e) mb. Këto fjalë, që përdoren kryesisht si terma të bujqësisë (por edhe në kirurgjinë plastike MD), nuk janë përfshirë në FGJSSH, sepse në vend të tyre përdoren fjalët shqipe **artis**, **artiset**, **artisje**, **artisur** (i, e). Ja një varg shembujsh, ku fjalët e huaja zëvendësohen me fjalët përkatëse të shqipes: *Artis lulet. Artisen bredhat. Artisja e fidanëve. Domate të artisura*. Këto fjalë të shqipes zëvendësojnë edhe fjalët me temë të huazuar nga italishtja **trapiantoj**, **trapiantohet**, **trapiantim**, **trapiantuar** (i, e) që përdoren, pa nevojë, me po ato kuptime. Në raste të veçanta në vend të **transplantoj** përdoret folja **përandit**, me kuptimin “shkul një bimë nga vendi ku është mbjellë dhe e ngul në një vend tjetër për ta rritur; i rralloj bimët”, p.sh.: *Përanditën pishat. Përanditën bredhat*. Po kështu zëvendësohen edhe fjalët e prejardhura **transplantim** dhe **transplantuar** (i, e) përkatësisht me **përanditje** dhe **përanditur** (i, e), p.sh.: *Përfunduan përanditjen e bimëve. Bredha të përanditur.*

turn, ~i m. Fjalë me prejardhje nga gjuhët neolatine. E ka edhe FGJSSH, por pa shpjegim; në vend të saj këshillohet fjala shqipe **ndërresë**, p.sh.:

Ndërresa e parë (e dytë, e tretë). Ndërresa e paradites. Ndërresa e natës. Përgjegjës ndërrese. Punë me dy (me tri) ndërresa. Mori (filloi) ndërresën. Fjala **ndërresë** përdoret edhe në ushtri për një grup të organizuar ushtarësh, që kryejnë veprime të caktuara, p.sh.: *Ndërresa e parë barkas. Përgjegjës i ndërresës.*

tutel/ë, ~a f., tutor, ~i m., tutori, ~a f. Këto fjalë e kanë prejardhjen nga italishtja. Kuptimi i fjalës librore **tutelë** mbulohet me fjalën shqipe **kujdestari**, p.sh.: *E futi (e mbajti) nën kujdestari. Doli nga kujdestaria. Vende nën kujdestari.* Emrat **tutor, ~i** dhe **tutori, ~a** janë përdorur si terma në drejtësi, ndërsa sot janë zëvendësuar përkatësisht me fjalët shqipe **kujdestar, ~i** dhe **kujdestari, ~a**, p.sh.: *Kujdestari i fëmijëve. E vunë (e kanë, e morën) nën kujdestari.*

unanim, ~e mb., unanimisht ndajf., unanimitet, ~i m. Janë fjalë me burim nga gjuhët neolatine. FGJSSH fjalët **unanim, ~e** dhe **unanimisht** i ka çuar përkatësisht te fjalët shqipe (i. e) **njëzëshëm** dhe **njëzëri**, që i mbulojnë ato në të gjitha kuptimet e përdorimet: *Vendim (mendim, pranim) i njëzëshëm. Përkrahje (kërkesë) e njëzëshme. Vota të njëzëshme. U miratua (u pranua, u pëlqye) njëzëri. E zgjodhën (e dënuan) njëzëri.* Fjala **unanimitet, ~i**, që përdoret në stilin libror, zëvendësohet me fjalën **njëzëshmëri, ~a**, p.sh.: *Njëzëshmëri e plotë. Parimi i njëzëshmërisë. Shprehje e njëzëshmërisë.* E shoqëruar me parafjalën **me**, pra në shprehjen **me unanimitet**, është zëvendësuar, ashtu si ndajfolja unanimisht, me fjalën shqipe **njëzëri**. p.sh.: *U vendos njëzëri. Përfundimet i miratuan njëzëri.*

unifikoj kal., unifikohet pës., unifikim, ~i m., unifikuar (i, e) mb. Këto janë fjalë të ligjërimit libror, me temë nga gjuhët neolatine, gjenden edhe në FGJSSH, por pa shpjegime. Në vend të fjalëve të huazuara këshillohet që të përdoren fjalët shqipe **njësoj. njësohet; bashkoj, bashkohet; njësim, bashkim, njësuar (i, e), njësishtëm (i, e), bashkuar (i, e)**, p.sh.: *Njësuani normën gjuhësore. U njësuani çmimet. U njësuani programet e shkollave. U njësuani një organizatë (një parti). Njësohen mendimet (pikëpamjet). Bashkohen organizatat. Bashkojnë forcat. Njësimi i monedhës (i normave, i kërkesave). Forcojnë bashkimin. Norma (çmime) të njësuara. Shkolla e njësuari. Gjuha e njësuari letrare. Drejtshkrimi i njësishtëm.*

uniform—e mb. Kjo fjalë e leksikut libror ka hyrë nga gjuhët neolatine. FGJSSH e jep pa shpjegim, duke e çuar te fjala shqipe **njëtrajtshëm**, e cila e zëvendëson në të gjitha kuptimet e përdorimet Kështu p. sh., thuhet: *Përhapje (shpërhapje) e njëtrajtshme. Dridhje (prerje) e njëtrajtshme. Lëvizje e njëtrajtshme* (si term në fizikë, në vend të lëvizje **uniforme**). Edhe fjala **uniformitet, ~i** zëvendësohet në të gjitha kuptimet e përdorimet me fjalët shqipe **njëtrajtshmëri** dhe **njëtrajtësi**, p.sh. *Njëtrajtshmëria (njëtrajtësia) e tokës. Njëtrajtshmëria (njëtrajtësia) e shtresës, Njëtrajtshmëria*

(*njëtrajtësia*) e lëvizjes (fiz.).

univers, ~i m. Fjalë e stilit libror, me burim nga latinishtja. Në vend të saj prej kohësh në gjuhën shqipe përdoret fjala **gjithësi**, të cilën e këshillon edhe FGJSSH, p.sh.: *Ligjet (të fshehtat) e gjithësisë. Studimi i gjithësisë.*

urban, ~e mb., interurban, ~e mb. Fjalë të huazuara nga gjuhët neolatine. Në vend të fjalës **urban, ~e** mund të përdoren fjalët shqipe **qytetor, ~e** ose **qytetës, ~e** p.sh.: *Shërbimi (transporti) qytetor (qytetës)*, kurse në vend të fjalës **interurban, ~e** mund të përdoret fjala **ndërqytetor, ~e** ose **ndërqytetës, ~e** p.sh.: *Telefon (autobus) ndërqytetor (ndërqytetës)*. Këto fjalë që i këshillon edhe FGJSSH, kanë nisur të përdoren edhe në shtypin e përditshëm.

urgjent, ~e mb., urgjent ndajf. Janë fjalë me burim nga italishtja. Mbiemri **urgjent, ~e** mund të zëvendësohet, sipas rastit, me fjalët shqipe i **ngutshëm, i menjëhershëm, i shpejtë**, p.sh.: *Punë (detyrë, çështje) e ngutshme. Nevojë e ngutshme. Është tepër e ngutshme. Ndihmë e shpejtë. Mori masa të menjëhershme. Telegram i ngutshëm. Lajmthirrje e ngutshme.* Edhe për ndajfoljen **urgjent** mund të përdoren fjalët shqipe **menjëherë, ngutësisht**, p.sh.: *U nisën menjëherë (ngutësisht). E dërgoi menjëherë (ngutësisht).*

vadit kal., vaditj/e, ~a f., vaditur (i, e) mb., vaditës, ~e mb., vaditës/e, ~ja f. Këto fjalë, me temë nga sllavishtja, i ka edhe FGJSSH, por pa shpjegime. Në vend të tyre këshillon që të përdoren fjalët shqipe **ujit, ujitj/e, ~a, i (e) ujitur, ujitës, ~e, ujitës/e, ~ja**, p.sh.: *Ujit tokën. Ujit bimët (lulet). Ujiten fushat. Kanal (rrjet) ujitës. Vijë (makinë, aftësi) ujitëse. Ujitëse lulësh. Ujitje e plotë (e pjesshme). Ujitja e grurit (e misrit). Afati i ujitjes. Tokë (sipërfaqe) e ujitur. Bimë të ujitura.* Fjalët **vadit** dhe i (e) **vaditur** vijnë të përdoren krahas togjeve të tjera të shqipes me kuptim të përafërt p.sh.: *U lanë me gjakun e shokëve. Larë me gjak. I larë në djersë.*

verbal, ~e mb., verbalisht ndajf. Fjala **verbal** ka hyrë në gjuhën shqipe nga gjuhët neolatine. FGJSSH nuk e ka këtë fjalë, sepse është zëvendësuar me shqipen **gojor, ~e**, p.sh.: *Agjitacion gojor. Kuptim gojor. Udhëzime (të dhëna) gojore. Kërkesë (deklaratë, notë) gojore. Marrëveshje gojore. Metodë (formë, kujtesë) gojore.* Edhe ndajfolja **verbalisht**, e formuar brenda shqipes nga tema e fjalës së huazuar dhe prapashtesa **-isht**, është zëvendësuar tashmë me fjalët shqipe **gojarisht, me gojë**, p.sh.: *U morën vesh gojarisht. E lajmëroi gojarisht. E paraqiti kërkesën gojarisht. E njoftuan gojarisht.*

violencë, ~a f., violent, ~e mb. Fjalë të huaja që kanë hyrë në gjuhën shqipe nga italishtja. Nuk i ka FGJSSH. Në vend të **violencë** në shqipe përdoret prej kohësh fjala **dhunë**. Ja një varg shembujsh ku fjala e huaj

violencë është zëvendësuar me fjalën shqipe: *Akt dhune. Me dhunë. Përdor dhunën. Marr (fitoj) me dhunë (me forcë).* Fjala *violent* mund të zëvendësohet me **i dhunshëm** ose **me dhunë**: *Veprim i dhunshëm (me dhunë).*

violet *mb.* Fjali me burim nga gjuhët neolatine. FGJSSH nuk e shpjegon, por në vend të saj jep fjalën **vjollcë**, p.sh.: *Ngjyrë vjollcë. Fustan vjollcë.* Edhe termi i fizikës **ultraviolet**, që përdoret kryesisht në togun **rreze ultraviolet**, zëvendësohet me formimin **ultravjollcë**, pra duke shqipëruar vetëm pjesën e dytë **violet** me shqipen **vjollcë**, p.sh.: *Rreze ultravjollcë.*

vitikultur/ë, ~a f., vitikultur, ~e mb. Këto fjalë, me burim nga gjuhët neolatine, janë përdorur si terma në bujqësi. Fjalën **vitikulturë** e jep edhe FGJSSH me dy kuptime: 1. Kultura e hardhisë; 2. Degë e shkencës bujqësore që merret me rritjen e hardhisë. Krahas këtij shpjegimi jepet edhe sinonimi **vreshtari**. Në të dy kuptimet fjala **vitikulturë** zëvendësohet me fjalën **vreshtari**, për të cilën FGJSSH jep shpjegime të plota, “degë e bujqësisë që merret me rritjen e hardhisë; kultura e hardhisë; mjeshtëria e vreshtarit”. Termin **vitikultur** “Fjalori” nuk e jep fare, sepse për këtë kemi fjalën **vreshtar** për të dy kuptimet “ai që punon vreshtat” dhe “ai që merret me vreshtari”. Prandaj sot përdoren rregullisht: *Zhvillimi i vreshtarisë. Studime në fushën e vreshtarisë. Dega e vreshtarisë. Merret me vreshtari. Vreshtar me përvojë etj.*